

# Raport Final

## **PERMBLEDHJA E GJETJEVE KRYESORE TE VROJTIMIT TE TURISTEVE, GRUPEVE TE FOKUSUARA DHE NUMERIMIT TE TURISTEVE 2020**

**Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin**

**Përgatitur nga:  
Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QSHKE)  
[www.acer.org.al](http://www.acer.org.al)**

**Tiranë, Dhjetor 2020**

**Raporti Final “Përmbledhja e gjetjeve kryesore të vrojtimit të turistëve, grupeve të fokusuara dhe numërimit të turistëve, 2020”** është përgatitur nga QSHKE me mbështetjen e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) në kuadër të zbatimit të PZHIUT. Ky vrojtim, analiza dhe rekomandimet që gjenden në këtë dokument përfaqësojnë vetëm opinionet e autorëve, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht analizën, qëndrimet dhe opinionet e Bankës Botërore, apo Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si dhe as të donatorëve ose palëve të përfshira në Projektin për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin.

**Koordinimi, zbatimi i kërkimit dhe përgatitja e raportit:**

Dr. Zef Preci

Ramadan Sopot (M.Sc)

Bylyre Serjanaj (M.Sc)

Amena Losha (M.Sc)



Ky projekt është financuar nga Banka Botërore në zbatim të PZHIUT. Qëllimi i zhvillimit të PZHIUT për Shqipërinë është përmirësimi i infrastrukturës urbane, fuqizimi i aseteve të turizmit dhe përmirësimi i aftësive institucionale për të mbështetur zhvillimin ekonomik lokal të lidhur me turizmin në zonat e zgjedhura në jug të Shqipërisë.

## Falenderime

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QSHKE) dëshiron të falenderojë të gjithë ata persona që ndanë kohën, informacionin dhe inputet për intervistat, pjesëmarrjen në diskutimet e grupeve të fokusuara dhe konsultimet e zhvilluara gjatë të gjithë procesit.

Dëshirojmë të falenderojmë ekipin e punës të angazhuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave statistikore të pasyruara në këtë raport. Falenderojmë ekspertët për mendimet dhe rekomandimet e tyre të vyera mbi të dhënat e vrojtimit 2020 dhe krahasimi me të dhënat e vrojtimit 2019, 2018 dhe studimin bazë.

Mirënjohje dhe falenderime të veçanta për ekipin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), për bashkëpunimin konstruktiv gjatë gjithë procesit të përgatitjes e kryerjes së vrojtimit, si dhe të grumbullimit të informacionit plotësues.

Së fundmi, por jo nga rëndësia, falenderojmë z. Edmond Baka (FSHZH), për mbështetjen dhe kontributin e veçantë në të gjithë hapat e zhvillimit të këtij vlerësimi, si dhe për mendimet e vlefshme mbi strukturën dhe përmbajtjen e raportit.

## Tabela e Përmbajtjes

Lista e Akronimeve .....	7
Përmbledhja Ekzekutive .....	8
Hyrje.....	10
Kapitulli 1. Vrojtimi i Turistëve 2020.....	12
1.1 Qëllimi dhe Objektivat e Vrojtimit.....	12
1.2 Koordinimi dhe Zbatimi i Vrojtimit.....	12
1.3 Metodologjia e Studimi Sasior .....	13
1.3.1 Kampioni i Vrojtimit .....	13
1.3.2 Zgjedhja dhe Trajnimi i Intervistuesve .....	14
1.3.3 Angazhimi i Mbikqyrësve të Vrojtimit Rajonal .....	14
1.3.4 Grumbullimi Elektronik i të Dhënave .....	14
1.3.5 Detaje të Tjera rreth Vrojtimit në Terren .....	16
1.4 Limitet e Studimit .....	16
Kapitulli 2. Gjetjet e Vrojtimit të Turistëve 2020 .....	17
2.1 Profili Demografik i Turistëve .....	17
2.2 Hyrja dhe Koha e Qëndrimit.....	20
2.3 Kënaqësia e Turistëve .....	22
2.3.1 Diversiteti i Aktiviteteve në Destinacionet Turistike .....	23
2.3.2 Cilësia e Produkteve, Shërbimeve dhe Mikpritja.....	26
2.3.3 Aspekte të tjera Turistike 2016, 2018, 2019 dhe 2020 .....	37
2.4 Informacioni mbi Shpenzimet e Turistëve.....	45
Kapitulli 3. Përmbledhja e Gjetjeve mbi Studimin Cilësor.....	49
3.1 Metodologjia e Studimit Cilësor .....	49
3.2 Limitet e Studimit cilësor .....	49
3.3 Gjetjet e Diskutimeve në Grupe të Fokusuara .....	49
Kapitulli 4. Numërimi i Turistëve.....	53
4.1 Metodologjia e Përdorur mbi Numërimin e Turistëve .....	53
4.2 Gjetjet mbi Numërimin e Turistëve .....	53
Kapitulli 5. Konkluzione dhe Rekomandime.....	55
Aneks 1: Pyetësi i Vrojtimit të Turistëve.....	57
Aneks 2: Materiale Informuese mbi DGF.....	62
Aneks 3: Gjetjet e Grupeve të Fokusuara .....	66
3/1 Diskutime në grup të fokusuar - Berat.....	66
3/2 Diskutime në grup të fokusuar - Përmet .....	68
3/3 Diskutime në grup të fokusuar - Gjirokastrë .....	70
3/4 Diskutime në grup të fokusuar - Sarandë .....	72
Aneks 4: Listë Prezenca dhe Foto DGF .....	74

## Lista e Tabelave

Tabela 1. Shpërndarja e turistëve sipas kohës së qëndrimit 2016-2020 .....	21
Tabela 2. Koha e qëndrimit sipas destinacionit 2016, 2018, 2019 dhe 2020 .....	21
Tabela 3. Vlerësim i përgjithshëm i kënaqësisë së turistëve sipas destinacionit 2016-2020 .....	23
Tabela 4. Vlerësim i përgjithshëm i kënaqësisë së turistëve sipas gjinisë 2016-2020.....	23
Tabela 5. Aktivitetet e realizuara dhe vlerësimi i cilësisë së përvojave.....	24
Tabela 6. Aktivitetet e realizuara dhe vlerësimi i cilësisë së përvojave 2016-2020 .....	25
Tabela 7. Aktivitetet e realizuara dhe vlerësimi i cilësisë së përvojave 2016-2020 .....	25
Tabela 8. Aktivitetet e realizuara dhe vlerësimi i cilësisë së përvojave 2016 - 2020 .....	26
Tabela 9. Vlerësimi i aspekteve të qëndrimit, duke marrë në konsideratë të gjithë Shqipërinë Jugore .....	26
Tabela 10. Vlerësimi i sigurisë personale, duke marrë në konsideratë të gjithë Shqipërinë Jugore .....	27
Tabela 11. Siguria personale, disagreguar sipas statusit të turistit 2016-2020.....	28
Tabela 12. Siguria personale, e disagreguar sipas statusit të turistit 2016-2020.....	28
Tabela 13. Vlerësimi i mikëpritjes së njerëzve, duke marrë në konsideratë të gjithë Shqipërinë Jugore .....	29
Tabela 14. Miqësia e njerëzve, disagreguar sipas statusit të turistit 2016-2020 .....	29
Tabela 15. Miqësia e njerëzve, disagreguar sipas statusit të turistit 2016-2020 .....	30
Tabela 16. Vlerësimi i aspekteve të qëndrimit, duke marrë në konsideratë të gjithë Shqipërinë Jugore .....	30
Tabela 17. Kuzhina vendase/pijet, disagreguar sipas statusit të turistit 2016-2020 .....	31
Tabela 18. Kuzhina vendase/pijet, disagreguar sipas statusit të turistit 2016-2020 .....	31
Tabela 19. Vlerësimi i cilësisë së restoranteve, duke marrë në konsideratë të gjithë Shqipërinë Jugore.....	31
Tabela 20. Cilësia e restoranteve, disagreguar sipas statusit të turistit 2016-2020.....	32
Tabela 21. Cilësia e restoranteve e grupuar, disagreguar sipas statusit të turistit 2016-2020.....	32
Tabela 22. Vlerësimi i aspekteve të qëndrimit, duke marrë në konsideratë të gjithë Shqipërinë Jugore .....	33
Tabela 23. Vlerësimi i aspekteve të qëndrimit, duke marrë në konsideratë të gjithë Shqipërinë Jugore .....	33
Tabela 24. Vlerësimi i aspekteve të qëndrimit, duke marrë në konsideratë të gjithë Shqipërinë Jugore .....	34
Tabela 25. Vlerësimi i aspekteve të qëndrimit, duke marrë në konsideratë të gjithë Shqipërinë Jugore .....	35
Tabela 26. Përshtatshmëria për transaksionet e pagesave me kartë krediti/debiti 2016-2020.....	36
Tabela 27. Përshtatshmëria për transaksionet e pagesave me kartë krediti/debiti 2016-2020.....	36
Tabela 28. Vlerësimi i aspekteve të qëndrimit, duke marrë në konsideratë të gjithë Shqipërinë Jugore .....	36
Tabela 29. Cilësia e guidave, disagreguar sipas statusit të turistit 2016-2020 .....	37
Tabela 30. Cilësia e guidave, disagreguar sipas statusit të turistit 2016-2020 .....	37
Tabela 31. Lehtësia e gjetjes së informacionit rreth zonës turistike para vizitës .....	38
Tabela 32. Lehtësia e gjetjes së informacionit rreth zonës turistike, 2016-2020 .....	38
Tabela 33. Lehtësia e gjetjes së informacionit rreth zonës turistike, 2016 - 2020 .....	39
Tabela 34. Lehtësia e gjetjes së destinacionit.....	39
Tabela 35. Lehtësia e gjetjes së vendndodhjes së destinacionit, 2016-2020 .....	39
Tabela 36. Lehtësia e gjetjes së vendndodhjes së destinacionit, 2016-2020 .....	40
Tabela 37. Cilësia e shtigjeve në zonat turistike .....	40
Tabela 38. Cilësia e shtigjeve në zonat turistike disagreguar sipas statusit të turistëve 2016-2020.....	41
Tabela 39. Cilësia e shtigjeve në zonat turistike disagreguar sipas statusit të turistëve 2016 - 2020.....	41
Tabela 40. Sinjalistika në zonat turistike .....	41
Tabela 41. Sinjalistika disagreguar sipas statusit të turistëve 2016-2020.....	42
Tabela 42. Sinjalistika disagreguar sipas statusit të turistëve 2016-2020.....	42
Tabela 43. Niveli i Pastërtisë në zonat turistike.....	42
Tabela 44. Niveli i Pastërtisë disagreguar sipas statusit të turistëve 2016-2020 .....	43
Tabela 45. Niveli i Pastërtisë disagreguar sipas statusit të turistëve 2016-2020 .....	43
Tabela 46. Cilësia dhe disponueshmëria e objekteve sanitare në zonat turistike .....	43
Tabela 47. Cilësia dhe disponueshmëria e objekteve sanitare, 2016-2020 .....	44

Tabela 48. Cilësia dhe disponueshmëria e objekteve sanitare, 2016 - 2020 .....	44
Tabela 49. Fasilitete për fëmijë në zonat turistike .....	45
Tabela 50. Fasilitete për fëmijë disagreguar sipas statusit të turistëve 2016-2020 .....	45
Tabela 51. Fasilitete për fëmijë disagreguar sipas statusit të turistëve 2016 - 2020 .....	45
Tabela 52. Shpenzimet mesatare të turistëve në ditë 2016-2020 (EUR) .....	46
Tabela 53. Shpenzimet mesatare të turistëve në ditë 2016-2020 (EUR) .....	46
Tabela 54. Shpenzimet mesatare të turistëve në ditë sipas statusit të turistit 2016-2020(EUR) .....	47
Tabela 55. Shpërndarja e turistëve sipas vlerësimit të kënaqësisë në lidhje me qëndrimin e tyre .....	47
Tabela 56. Shpërndarja e turistëve sipas vlerësimit të kënaqësisë në lidhje me qëndrimin e tyre .....	48
Tabela 57. Numri i bizneseve lidhur me turizmin 2018, 2019 dhe 2020 .....	48
Tabela 58. Të dhëna për Diskutimet në Grup të Fokusuar.....	49
Tabela 59. Barrierat e përbashkëta dhe zgjidhjet përkatëse në secilin qark .....	52
Tabela 60. Numri mesatar i turistëve gjatë shtatë ditëve të javës, 2020 .....	53
Tabela 61. Numri mesatar i turistëve gjatë shtatë ditëve të javës, 2019 .....	54
Tabela 62. Numri mesatar i turistëve gjatë shtatë ditëve të javës 2018.....	54
Tabela 63. Përqindja e uljes së numrit mesatar të turistëve duke krahasuar vitin 2019 me 2020 .....	54

## Lista e Figurave

Figura 1. Turistët e intervistuar sipas gjinisë dhe grupmoshës 2016-2020.....	18
Figura 2. Kategorizimi i turistëve sipas statusit të rezidentit, punësimit dhe arsimit.....	19
Figura 3. Pikat hyrëse në Shqipëri dhe frekuenca e vizitave 2016-2020.....	20
Figura 4. Lloji i turistëve 2016-2020 .....	22
Figura 5. Shërbimet doganore dhe të imigracionit në pikat hyrëse 2016-2020 .....	27
Figura 6. Siguria personale 2016-2020 .....	28
Figura 7. Miqësia e njerëzve 2016-2020.....	29
Figura 8. Kuzhina/ Pijet Vendase 2016-2020.....	30
Figura 9. Cilësia e restoranteve 2016-2020 .....	32
Figura 10. Cilësia e shërbimeve në restorante, hotele etj. 2016-2020.....	33
Figura 11. Shkalla e njohjes së gjuhës së huaj nga personeli i shërbimit 2016-2020 .....	34
Figura 12. Përshtatshmëria për transaksionet e pagesave me kartë krediti/debiti 2016-2020.....	35
Figura 13. Cilësia e guidave 2016-2020.....	37
Figura 14. Lehtësia e gjetjes së informacionit rreth zonës turistike.....	38
Figura 15. Lehtësia e gjetjes së destinacionit .....	39
Figura 16. Cilësia e shtigjeve në zonat turistike .....	40
Figura 17. Sinjalistika në zonat turistike.....	41
Figura 18. Niveli i Pastërtisë në zonat turistike .....	42
Figura 19. Cilësia dhe disponueshmëria e objekteve sanitare në zonat turistike .....	44
Figura 20. Fasilitete për fëmijë në zonat turistike .....	45

## Lista e Akronimeve

<b>COVID-19</b>	– Korona Virus 2019
<b>DGF</b>	– Diskutime në Grupe të Fokusuara
<b>EJL</b>	– Evropa Juglindore
<b>FSHZH</b>	– Fondi Shqiptar i Zhvillimit
<b>GEDH</b>	– Grumbullimi Elektronik i të Dhënave
<b>IAK</b>	– Intervistat e Asistuar nga Kompjuteri
<b>INSTAT</b>	– Instituti i Statistikave
<b>MTM</b>	– Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
<b>OBEZH</b>	– Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
<b>OBT</b>	– Organizata Botërore e Turizmit
<b>PBB</b>	– Produkti i Brendshëm Bruto
<b>PZHIUT</b>	– Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin
<b>QSHKE</b>	– Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike

## Përmbledhja Ekzekutive

Raporti final “Përmbledhja e Gjetjeve Kryesore të Vrojtimin të Turistëve, Grupeve të Fokusuara dhe Numërimit të Turistëve, 2020”, është i organizuar në 5 (pesë) kapituj. Kapitulli i parë paraqet një përshkrim të Vrojtimin të Turistëve 2020 mbi qëllimin dhe metodologjinë e përdorur; Kapitulli i dytë analizon Gjetjet e Vrojtimin të Turistëve, 2020 duke bërë njëkohësisht një krahasim të të dhënave me vërtetimin e vitit 2019, 2018 dhe studimin bazë 2016; Kapitulli i tretë përshkruan Gjetjet e Diskutimeve në Grupe të Fokusuara; ndërkohë Gjetjet e Numërimit të Turistëve në 9 destinacione turistike të përfshira në projekt gjenden në kapitullin 4 (katër); dhe konkluzionet apo rekomandimet e nxjerra nga vërtetimi i turistëve 2020 dhe diskutimet në grupe të fokusuara gjenden në Kapitullin 5 (pesë).

Vërtetimi i Turistëve 2020 është realizuar nga Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QSHKE), kontraktuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH). QSHKE realizoi vërtetimin e turistëve në 9 zona turistike, në të cilat po zbatohet Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin (PZHIUT), si dhe katër diskutime online në grupe të fokusuara në 4 qendrat urbane të përzgjedhura për zbatimin e PZHIUT. Instrumenti është mbështetur në pyetësorin e studimit bazë në vitin 2016, vërtetimin e vitit 2018 dhe 2019. Këtë vit, vërtetimi u krye nga data 16-31 gusht në 4 zonat urbane: Sarandë, Berat, Përmet dhe Gjirokastër, si dhe në zonat turistike: Syri i kaltër, Porto Palermo, Zvërnec, Orik dhe Bënjë, njësoj si në vërtetimin e vitit 2019 dhe 2018. Për të ruajtur krahasueshmërinë e të dhënave është përdorur e njëjta metodologji dhe i njëjti instrument vërtetimi (shih [Aneks I](#)).

Pavarësisht sfidave me të cilat u përball turizmi në Shqipëri gjatë vitit 2019-2020 (tërmeti i 26 Nëntorit, 2019 dhe Covid-19, 2020) Vërtetimi i Turistëve 2020 ka patur si synim të sigurojë informacion të besueshëm për perceptimet e turistëve (vizitorëve) mbi produktet ekzistuese të turizmit në qendrat urbane ku po zbatohet PZHIUT. Vërtetimi siguron të dhëna të dobishme mbi problematikat e hasura në zonat turistike dhe një mundësi për përmirësim në vitet e ardhshme. Më e rëndësishmja është se, vërtetimi ofron një pamje të perceptimeve të vizitorëve në këto 4 qendra urbane si një destinacion turistik, duke krijuar mundësi krahasimi me rezultatet e të njëjtit vërtetim të kryer në vitin 2019, 2018 dhe 2016. Vërtetimi analizon si kënaqësinë me objektet e turizmit, ashtu edhe dimensionet e përvojës turistike. Për të bërë një vlerësim të perceptimit dhe përvojave të turistëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, mbi kënaqësinë e tyre gjatë qëndrimit në Shqipëri në katër rajonet e studiuara, QSHKE përgatiti një raport studimor për vitin 2020 të gjeneruar nga vërtetimi i 1.260 vizitorëve dhe katër Diskutimeve në Grupe të Fokusuara (DGF).

Në vijim, janë përmbledhur gjetjet kryesore të studimit sasior dhe cilësor për vitin 2020, duke përdorur si bazë krahasuese rezultatet e vitit 2019, 2018 dhe 2016.

- ❖ Rezultatet e vërtetimit për vitin 2020 tregojnë se më pak se 2/3 e turistëve (63%) janë turistë ndërkombëtarë, pra është ulur përqindja e turistëve ndërkombëtarë (vizitorë të huaj dhe shqiptarë jo-rezident), krahasuar me vitin 2019 (74.8%), studimin e vitit 2018 (80%) dhe 2016 (64%). Të dhënat nga diskutimet në grupe të fokusuara tregojnë se mbi 90% e turistëve ndërkombëtarë ishin nga Evropa Lindore, ndryshe nga vitet e kaluara që pjesa më e madhe e turistëve ndërkombëtarë vinin nga Evropa Perëndimore.



- ❖ Në vitin 2020, më shumë se 1/2 e turistëve (56.4%) deklarojnë se qëndrojnë mesatarisht tetë ditë në Shqipëri. Krahasuar me vitin 2019, 2018 dhe 2016 vihet re një ulje e numrit të turistëve, që kanë qëndruar mesatarisht tetë ditë në Shqipëri. Koha e qëndrimit të turistëve në vend, është një tregues shumë i rëndësishëm i potencialit që ka Shqipëria për të ofruar për turistët, në terma aktivitetesh apo shërbimesh, por për vitin 2020 situata e shkaktuar në vend nga pandemia ka ndikuar në kohën e qëndrimit të turistëve në zonat turistike.
- ❖ Në Vrojtimin e vitit 2020, është rritur përqindja e turistëve që pohojnë se e kanë vizituar më shumë se një herë Shqipërinë (nga 22% në 28%) dhe zonat turistike (nga 29.6% në 44%). Këto rezultate tregojnë dhe tejkrijnë mesazhin e rëndësishëm të garantimit të kënaqësisë së turistëve me qëllim përsëritjen e përvojave në të ardhmen.
- ❖ Vrojtimi i Turistëve në vitin 2020, tregon një nivel të lartë të kënaqësisë së përgjithshme të turistëve (4.08). Krahasuar me studimin e vitit 2018 (4.07) dhe studimin e vitit 2019 (4.05), niveli mesatar i kënaqësisë së përgjithshme, ka pësuar rritje të lehtë.
- ❖ Nivelet më të larta të kënaqësisë rezultojnë për aktivitetet e eksplorimit të parqeve natyrore [kryesisht në Zvërnec (4.92); Sarandë (4.89) dhe Bënjë (4.86)], fshatrat [kryesisht në Zvërnec, Gjirokastrë (4.63) dhe Bënjë (4.56)] dhe kishat [(kryesisht në Zvërnec (4.62), Sarandë (4.48) dhe Gjirokastrë (4.49)].
- ❖ Nivelet më të ulëta të kënaqësisë së turistëve në lidhje me aktivitetet, rezultojnë kryesisht për aktivitetet muzikore [kryesisht në Përmet (3.33), Bënjë (3.60) dhe Sarandë (3.67)] dhe gastronominë vendase [kryesisht në Përmet (3.91) dhe Syri i Kaltër (3.99)].
- ❖ Në terma të përgjithshëm, vihet re një rritje e kënaqësisë ndaj cilësisë së shërbimit (nga vlerësimi mesatar 3.03 në 3.2) në pikat hyrëse në Shqipëri, krahasuar me një vit më parë.
- ❖ Pavarësisht pandemisë globale Covid-19, nga vlerësimi i përgjithshëm mbi sigurinë personale vihet re një rritje e lehtë (nga 3.01 në 3.2) krahasuar me një vit më parë. Gjithashtu, pandemia ndikoi negativisht te ofruesit e shërbimit mbi guidat turistike (një pjesë e konsiderueshme e tyre u mbyllën), por pavarësisht kësaj periudhe të vështirë, ofruesit e guidave që vazhduan aktivitetin e tyre, arritën të ofronin shërbimin me një cilësi të lartë (2.64 në vitin 2019 krahasuar me 2.86 në vitin 2020).
- ❖ Në vitin 2020 një turist ka shpenzuar mesatarisht 46.68 Euro/ ditë, e cila në krahasim me vitin 2019, ka pësuar rënie prej 0.63 Euro/ditë të shpenzimeve mesatare ditore (ishte 48.82 Euro/ ditë).
- ❖ Ashtu si në vrotimet e viteve të mëparshme, në zonat e studiuara, fluksin më të madh të turistëve e kanë zonat bregdetare duke marrë parasysh edhe periudhën gjatë realizimit të vrotimit (muaji Gusht). Për vitin 2020 Saranda (m=1000), Syri i Kaltër (m=201), Zvërneci (m=125) dhe Kalaja në Gjirokastrë (m=125) janë zonat me mesatare më të lartë të numrit të turistëve.

Si përfundim mund të themi, që përgjithësisht turistët shprehin për një nivel të lartë të kënaqësisë totale gjatë vizitës së tyre në destinacionin pritës. Pavarësisht të dhënave sasiore, të dhënat e nxjerra nga diskutimet online të grupeve të fokusuara, tregojnë se ekzistojnë një sërë aspektesh problematike, që kërkojnë ndërhyrje dhe që duhet të përqendrohen në: (i) bashkëpunimi i pushtetit vendor me aktorë privat apo publik të përfshirë në zhvillimin e turizmit, (ii) përmirësimin e kushteve të përshtatshme infrastrukturore për aksesimin e aseteve turistike natyrore dhe kulturore në katër destinacionet e studiuara dhe (iii) promovimi efektiv i vlerave turistike.

## Hyrje

Turizmi në Shqipëri është një nga sektorët më të rëndësishëm për fuqizimin ekonomik në vend dhe me potencial të lartë zhvillimi. Turizmi ka zgjeruar potencialet natyrore dhe kulturore të destinacioneve turistike në Shqipëri duke ofruar një shumëllojshmëri të lartë të mundësive për turizmin, si: turizëm bregdetar (plazhe), turizëm rural, turizëm malor, kulturor, marshime, etj. Megjithatë, është e nevojshme të zhvillohet promovimi i këtyre destinacioneve për të tërhequr turistët, si të huaj edhe vendas, dhe për të rritur aksesin e tyre në informacion që tek imazhi që i pret e deri tek larmishmëria e aktiviteteve kur të mbërrijnë në destinacionin e caktuar. Viti 2020 u shpall që në nisje si “viti i turizmit dhe zhvillimit rural” nga Organizata Botërore e Turizmit (OBT)<sup>1</sup> për t'i dhënë rëndësi ekonomike udhëtimeve nëpër destinacionet rurale.

Gjithsesi, Shqipëria, ashtu si dhe bota nuk patën një vit të zakonshëm në 2020-ën dhe sektori i turizmit është nga më të dëmtuarit për shkak të përhapjes së pandemisë globale nga COVID-19, që paralizoi të gjithë botën. Turizmi i vitit 2020 në Shqipëri është përballur me sfida të panjohura më parë, si rrjedhojë e dy fatkeqësive natyrore të njëpasnjëshme: tërmeti i 26 Nëntor 2019 dhe pandemia e shkaktuar, të cilat sollën pasoja të rënda si nga ana njerëzore edhe nga ana ekonomike. Sektori i turizmit ishte ndër më të prekurit nga sektorët e tjerë ekonomik, marrë parasysh dhe faktin e përgatitjes për sezonin turistik, pikërisht në periudhën e mbylljes totale (karantinës), nga operatorët ekonomikë e bizneset që veprojnë në këtë fushë.

Aktualisht, dokumenti strategjik kryesor në fushën e turizmit është: Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023<sup>2</sup>. Dokumente të tjerë që kanë ndikuar dukshëm në zhvillimin e këtij sektori në vend janë: Strategjia Sektoriale: Plani Kombëtar Sektorial i turizmit, Rajoni i Alpeve Shqiptare, 2017;<sup>3</sup> Strategjia Ndërsektoriale “Axe Digjitale e Shqipërisë 2015-2020”;<sup>4</sup> Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020;<sup>5</sup> Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020<sup>6</sup>, por duhet theksuar se këto politika janë në vitin e fundit të implementimit dhe lind nevoja për përditësimin e tyre në vazhdim për të qenë sa më koherente me zhvillimet e vendit.

## Impakti i COVID-19

Nga publikimet mujore të Institutit të Statistikave (INSTAT) lidhur me shifrat e turizmit për vitin e fundit, konstatohet ajo që pritej të ndodhte – rënia e konsiderueshme hyrjeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj përgjatë periudhë Janar-Gusht 2020 (3,530,238 hyrje gjithsej) në krahasim me

<sup>1</sup>Organizata Botërore e Turizmit: <https://www.unwto.org/world-tourism-day-2020/tourism-and-rural-development-technical-note>

<sup>2</sup>Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, MTM <http://mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>

<sup>3</sup> Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit, Rajoni i Alpeve Shqiptare (Strategjia Sektoriale), 2017, zbatuar nga ADF: <https://www.albaniandf.org/wp-content/uploads/2018/07/2-STRATEGJIA-SEKTORIALE-PKST-ALPE.pdf>

<sup>4</sup> Strategjia Ndërsektoriale, Axe Digjitale e Shqipërisë 2015-2020, Këshilli i Ministrave, Republika e Shqipërisë: [http://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Digital\\_Agenda\\_Strategy\\_2015\\_-\\_2020.pdf](http://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Digital_Agenda_Strategy_2015_-_2020.pdf)

<sup>5</sup> Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, Këshilli i Ministrave, Republika e Shqipërisë: [http://www.mbrojtja.gov.al/images/PDF/strategji2016/SKZHI\\_FINAL\\_QBZ.pdf](http://www.mbrojtja.gov.al/images/PDF/strategji2016/SKZHI_FINAL_QBZ.pdf)

<sup>6</sup>Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020, Këshilli i Ministrave, Republika e Shqipërisë: <http://www.bpe.al/sites/default/files/publications/Strategjia-ndersektoriale-per-decentralizimin-dhe-qeverisjen-vendore.pdf>

të njëjtën periudhë në vitin 2019 (8,582,641 hyrje gjithsej).<sup>7</sup> Sipas INSTAT, hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në Shqipëri vetëm për muajin Gusht 2020 janë 846,973 duke pësuar një rënie të konsiderueshme me 62.5% krahasuar me muajin Gusht 2019.<sup>8</sup> Sipas Raportit të Vrojtitimit të Turistëve 2020, numri i përgjithshëm i turistëve ka rënë kryesisht në këto destinacione të Shqipërisë Jugore: Në Bënjë - Uji Termal me 40.2%; në Zvërnec me 33.5%; në Berat me 33.3%; në Gjirokastër me 30.9%; dhe në Përmet me 30%, krahasuar me vitin 2019. Referuar një tjetër burimi, Shoqata Shqiptare e Tur-operatorëve dhe Agjencive Turistike në Shqipëri, shprehen se ky sezon veror ka vetëm 20 për qind të totalit të turistëve që parashikohej në kohë normale duke ndikuar direkt në ekonominë e vendit.

Situtata e krijuar prej COVID-19 ndikoi në një ulje prej 10.23 % të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) në Shqipëri, referuar muajve Prill-Maj-Qershor 2020 krahasuar me të njëjtën periudhë në 2019-ën, kohë e cila i korrespondon nisjes së sezonit turistik nga një numër i lartë strukturash akomoduese dhe më gjerë. Grupi i aktiviteteve të cilët dhanë goditjen më të madhe në këtë ulje të PBB-ës ishin: tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbim ushqimor, (me një rënie prej 26,35 % në periudhën Prill-Maj-Qershor 2020 në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë).<sup>9</sup> Raporti i fundit i publikuar nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH), për ekonominë e vendeve të Evropës Juglindore (EJL) dhe përgjigjia ndaj krizës së COVID-19, thekson se Shqipëria është një ndër vendet që do të vuajë më shumë në ekonomi për shkak të kontributit që ka turizmi. Në raport citohet se “Turizmi, i cili kontribuon në më shumë se 20% të PBB-së së Shqipërisë, ishte një nga sektorët më të prekur nga pandemia”.<sup>10</sup>

Masat e ndërmarra nga qeveritë për të minimizuar ose zvogëluar shpërndarjen e virusit si kufizimet e udhëtimeve/ fluturimeve, mbyllja e kufijve, karantina dhe masat e distancës sociale etj., së bashku me impaktin mediatik në raportet e tyre periodike të lajmeve, bën që destinacionet turistike të jenë jo tërheqëse, dhe u përhap ndjesia e frikës tek vizitorët e ardhshëm. Padyshim që hotelet janë zinxhiri më i goditur nga COVID-19. Si rezultat i anulimeve masive të fluturimeve, tureve, ngjarjeve, rezervimeve të hoteleve dhe një rënie në udhëtimet brenda vendit, në numrin e zënies së shtretërve në hotele dhe rënia e ndjeshme e tarifave mesatare të dhomave shkaktuan rënie të pa precedent të marzheve të fitimit për këto struktura. Deri në 90% është shifra e anulimeve në strukturat akomoduese në zonat ku po ndërmerret projekti, sipas diskutimeve në grupet e fokusuara me palët e interesit në Berat, Përmet, Sarandë dhe Gjirokastër. Kështu, rezultatet e këtij raporti studimor i atribuohen ndër të tjera edhe faktorëve të jashtëm që lidhen me: Së pari, situatën e paqëndrueshme të krijuar në vend si rezultat i përhapjes së COVID-19, i cili vijon të jetë aktiv në gjithë vendin. Së dyti, pasojat e tërmetit të 26 Nëntorit 2019, që megjithëse ra me epiqendër në qytetin e Durrësit, i cili nuk është pjesë e projektit të PZHIUT-ës, por si vend i spikatur për numrin e lartë të turistëve, ndikoi në anulimet e rezervimeve nga shumë vizitorë potencialë që do të vizitonin Shqipërinë duke ndikuar kështu në zvogëlimin e hyrjeve të shtetasve të huaj dhe shqiptar në territorin e vendit dhe në kontributin që ata do t'i sillnin turizmit dhe ekonomisë.

<sup>7</sup> INSTAT, Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Gusht 2020: [http://www.instat.gov.al/media/7507/levizja-e-shtetasve-gusht\\_2020.pdf](http://www.instat.gov.al/media/7507/levizja-e-shtetasve-gusht_2020.pdf)

<sup>8</sup> Ibid.

<sup>9</sup> INSTAT, Rritja ekonomike tremujore, Tremujori II, 2020: <http://www.instat.gov.al/media/7519/pbb-tr2-2020.pdf>

<sup>10</sup> OBEZH, Kriza e COVID-19 në Shqipëri, 2020: <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Albania.pdf>

## Kapitulli I. Vrojtimi i Turistëve 2020

Për vlerësimin e zbatimit dhe arritjes së objektivave të PZHIUT-ës, u krye studimi sasior dhe cilësor nga QSHKE me qëllim nxjerrjen në fokus të kënaqësisë së turistëve, përdorimin e shërbimeve publike dhe infrastrukturës, si dhe të modeleve të shpenzimeve dhe qëndrimeve gjatë vizitës së turistëve në Shqipërinë e Jugut, gjë që lehtëson vlerësimin e ndikimit ekonomik të PZHIUT. Studimi sasior u realizua nëpërmjet një vrojtimi me një kampion prej 1,260 turistësh në Shqipërinë e Jugut. Për të qartësuar disa aspekte të veçanta të studimit sasior dhe për përforcimin e gjetjeve u pasua me një studim cilësor ku opinionet, përvojat dhe sugjerimet e palëve të përfshira u mblodhën nëpërmjet diskutimeve në grupe të fokusuara në 4 qytete: Berat, Përmet, Gjirokastrë dhe Sarandë. Më poshtë është përshkruar më në detaje metodologjia e përdorur për secilin studim.

### I.1 Qëllimi dhe Objektivat e Vrojtimit

Qëllimi i këtij vrojtimi është të ofrojë të dhëna me një fokus të veçantë në përdorimin e shërbimeve publike dhe infrastrukturës nga turistët si dhe nivelin e kënaqësisë së turistëve me këto shërbime, gjithashtu edhe prirjet e përgjithshme të shpenzimeve gjatë vizitës së tyre, gjë që mundëson një vlerësim më të plotë të ndikimit ekonomik të projektit.

Detyrat kyçe të grumbullimit të të dhënave, për vlerësim, janë: (i) një vrojtım përfaqësues të familjeve në secilën prej 4 qendrave urbane të përzgjedhura, përkatësisht në Berat, Gjirokastrë, Përmet, dhe Sarandë, (ii) një vrojtım përfaqësues (formal dhe jo-formal) të bizneseve të lidhura me turizmin në secilën prej 4 qendrave urbane të përzgjedhura, dhe (iii) një vrojtım të një numri të caktuar të turistëve në 9 vende të përzgjedhura turistike. Dy detyrat e para kanë për qëllim të japin të dhëna për familjet, nëse ata përfitojnë nga investimet e projektit dhe si, qoftë në mënyrë direkte - përmes shërbimeve publike, përmirësimit të infrastrukturës urbane ose vendeve të punës në projekte, ose indirekte - përmes rritjes së mundësive ekonomike të lidhura me këto investime, veçanërisht atyre që kanë të bëjnë me industrinë e turizmit.

### I.2 Koordinimi dhe Zbatimi i Vrojtimit

Koordinimi dhe zbatimi i përgjithshëm i vrojtimit ka qenë përgjegjësi e QSHKE. Ligjërisht dhe nga pikëpamja kontraktuale, QSHKE ka qenë përgjegjëse për një sërë çështjesh, të cilat u përmbushën përmes një bashkëpunimi të ngushtë me ekipin teknik të mbikëqyrësve të FSHZH-së. Disa nga këto përgjegjësi ishin:

- Identifikimi dhe kontaktimi i stafit për punën në terren,
- Trajnimi një-ditor për intervistuesit që zbatuan punën në terren,
- Sigurimi i bazës së nevojshme logjistike për kryerjen e vrojtimit,
- Administrimi i të dhënave të grumbulluara sipas standardeve të specifikuara si dhe përgatitja e tyre për analizën dhe interpretimin e gjetjeve të vrojtimit.

### **I.3 Metodologjia e Studimit Sasior**

Studimi sasior përfshiu vrojtimin e turistëve vizitorë në Shqipërinë e Jugut, zonë e cila është objekt i PZHIUT. Në mbështetje të termave të referencës së projektit, vrojtimi u zbatua në 9 vende të përzgjedhura sipas listës së mëposhtme. E njëjta përzgjedhje e vendeve e siguruar nga FSHZH është ndjekur në studimin e viteve 2019, 2018 dhe në studimin bazë të kryer në vitin 2016. Në secilën prej vendndodhjeve të përmendura më poshtë janë zhvilluar respektivisht nga 140 pyetësorë.

#### **Bashkitë:**

1. Sarandë – Shëtitorja
2. Gjirokastrë – Kalaja
3. Berat – Kalaja
4. Përmet – Qendra e Qytetit

#### **Pikat turistike:**

5. Bënjë – Ujërat Termale
6. Porto Palermo – Kalaja
7. Zvërnec – Hyrja e Kishës
8. Orik – Qyteti i Lashtë
9. Syri i Kaltër – Burimi

#### **I.3.1 Kampioni i Vrojtimit**

Turistët në këto zona kanë qenë njësia bazë e vrojtimit. Njësoj, si në rastin e metodologjisë në studimin bazë dhe në studimin e viteve 2018 dhe 2019, metoda e përdorur për përzgjedhjen e të intervistuarve është ajo e kampionimit aksidental. Kampionimi aksidental është një metodë jo-probabilitare përzgjedhje, e cila vjen si rezultat i pa mundësisë së identifikimit të të gjithë popullatës së marrë në studim. Për këtë arsye, intervistohen personat të cilët gjenden në këto zona të paracaktuara pa asnjë paragjykim. Në rastet e një grupi vizitorësh familjarë, është bërë e mundur që vetëm një anëtar i familjes të marrë pjesë në vrojtim. Në mënyrë që të sigurohej një kampion sa më përfaqësues i turistëve dhe gjithëpërfshirës intervistat janë kryer:

- a. Në ditë të ndryshme të javës
- b. Në kohë të ndryshme të ditës

Shpërndarja në mënyrë aksidentale e intervistave ka lejuar, që të kapen të gjitha nuancat në përdorimin dhe kënaqësinë e turistëve me shërbimet publike dhe infrastrukturën, si dhe shpenzimet gjatë qëndrimit të tyre. Nga vrojtimi i turistëve, ndër të tjera, dolën këto të dhëna sasiore:

1. Kohëzgjatja e vizitës;
2. Vendi i qëndrimit dhe mjetet e transportit;
3. Diversiteti i aktiviteteve të përfshira gjatë vizitës në këto vende;
4. Shuma e specifikuar e shpenzuar gjatë vizitës, si dhe;

5. Pritshmëria dhe kënaqësia me një sërë atributesh, duke përfshirë vendet turistike, akomodimin, ushqimin, aksesueshmërinë, transportin drejt dhe brenda vendit, infrastrukturën urbane, shpenzimet, trashëgiminë kulturore, etj.

### **1.3.2 Zgjedhja dhe Trajnimi i Intervistuesve**

Për zhvillimin e këtij studimi, QSHKE angazhoi një ekip prej tre mbikëqyrësish rajonal, të cilët mbështetën intervistuesit e përzgjedhur dhe mbikëqyrën zbatimin e vrojtimit të turistëve në terren. Trajnimi u mbajt më datë 13 Gusht 2020 dhe u përfshinë 14 intervistues, përmes një programi të posaçëm trajnimi një-ditor. Materialet e siguruara gjatë trajnimit lidheshin me zbatimin e punës në terren, instrumentet e vrojtimit dhe pyetësorët, përzgjedhjen e të intervistuarve sipas metodologjisë së vrojtimit, informacion mbi shtrirjen gjeografike të vrojtimit si dhe mbi përdorimin e tabletëve. Ndarja e intervistuesve sipas zonave u bë në këtë mënyrë: Saranda – 4 intervistues, Gjirokastra – 2 intervistues, Berati – 2 intervistues, Përmeti – 3 intervistues si dhe për mbulimin e pikave turistike të Orik (Qyteti i Lashtë) dhe Zvërnec (Hyrja e Kishës) – 3 intervistues. Të gjithë intervistuesit u pajisën me një numër udhëzimesh të shkruara të shpërndara përpara nisjes së punës në terren.

Puna në terren zgjati 2 javë, e cila filloi më 16 gusht 2020 dhe përfundoi më 31 gusht 2020. Së bashku me intervistat e kryera, intervistuesit numëruan turistët që vizitonin zonën atë ditë. Gjithashtu, në përfundim të kryerjes së intervistave, kanë numëruar të gjitha bizneset që ushtronin aktivitetin në atë zonë (ose afër vendit si në rastin e kalave).

### **1.3.3 Angazhimi i Mbikqyrësve të Vrojtimit Rajonal**

Për të mbikëqyrur punën në terren, 3 mbikëqyrësit u kontraktuan në secilën prej 4 zonave. Përmes komunikimit të vazhdueshëm të mbikëqyrësve me intervistuesit, çdo ditë u përgatit një plan pune në terren, i cili u raportua te koordinatori i projektit në zyrën e QSHKE. Koordinatori i QSHKE ka mbikëqyrur çdo ditë zbatimin e planit dhe ka raportuar çdo javë tek FSHZH. Mbikëqyrësit ndihmuan intervistuesit gjatë punës së tyre në terren, duke lehtësuar komunikimin me turistët e intervistuar dhe zbatimin me korrektesë të detyrës së ngarkuar.

### **1.3.4 Grumbullimi Elektronik i të Dhënave**

QSHKE ka përdorur teknologjinë elektronike për mbledhjen e të dhënave. Intervistat ballë-për-ballë u zhvilluan përmes sistemit IAK (Intervistat e Asistuar nga Kompjuteri). Për këtë qëllim, QSHKE disponon të gjitha mjetet e nevojshme si pajisjet elektronike (14 tableta), dhe kapacitetet për të kryer intervistat përmes Grumbullimit Elektronik të të Dhënave, të njohur ndryshe edhe si GEDH.

Siç dihet, ky sistem mundëson një numër përparësish, ndër të cilat përmendim:



Skriptet, që përcaktojnë formularin e hyrjes, kryejnë automatikisht kontrolle logjike, konsistencë dhe menjëherë njoftojnë intervistuesit për problematikat e mundshme. Gjatë dhe pas fazës së regjistrimit të të dhënave, të dhënat e pyetësorit i nënshtrohen disa llojeve të kontrolleve: Kontrollat e zonës; Kontrollat kundër të dhënave referuese; Kontrollat e konsistencës dhe Kontrollat tipografike. Më poshtë përshkruhen me më detaje:

- a. Kontrollat e intervaleve kanë për qëllim të sigurojnë që çdo ndryshore në pyetësor të përmbajë vetëm të dhëna brenda një fushe të kufizuar me vlera të vlefshme. Variablat kategorike mund të kenë vetëm një nga vlerat e paracaktuara për ta në pyetësor (për shembull, gjinia mund të kodohet vetëm si 1 për meshkuj ose 2 për femra); variablat kronologjike duhet të përmbajnë data të vlefshme dhe variablat numerikë duhet të qëndrojnë brenda vlerave minimale dhe maksimale të përshkruara (të tilla si 15 deri në 95 vjeç për moshën).



- b. Një rast i veçantë i kontrollit të distancës ndodh kur të dhënat nga dy ose më shumë fusha të lidhura ngushtë mund të kontrollohen kundër tabelave të referencës së jashtme, për shembull, siç është rasti i përputhshmërisë së rajoneve gjeografike.
- c. Kontrollë që verifikojnë nëse modelet e *skip* janë ndjekur në mënyrë të përshtatshme. Në varësi të moshës dhe gjinisë së tij/saj, çdo i intervistuar duhet të përgjigjet (ose të kalojë) seksione të veçanta të pyetësorit.
- d. Kontrollët e konsistencës verifikojnë se vlerat e një pyetjeje, janë në përputhje me vlerat e një pyetjeje tjetër. Një kontroll i thjeshtë ndodh kur të dy vlerat janë nga njësia e njëjtë statistikore, për shembull, data e lindjes dhe mosha e një individi të caktuar.
- e. Kontrollët tipografike. Përfundimet e kontrollit dhe procedurat e shenjave të kontrollit ndiqen kur është e mundur.

Çdo intervistë e kryer nga intervistuesi u ngarkua menjëherë në serverin e dedikuar të vendosur në ambientet e QSHKE. Baza e të dhënave përditësohet në mënyrë progresive në server që na lejon të kontrollojmë statusin e procesit të grumbullimit të të dhënave. Serveri ruan bazën e të dhënave në një skedar rezervë. Është bërë regjistrimi automatik në sistemin e kohës dhe datës së intervistës. Funkcioni i gjeo-vendndodhjes lejon regjistrimin dhe ndjekjen e vendndodhjes së intervistës dhe duke sjellë një paraqitje grafike të secilit pyetësor në punën në terren (duke kontrolluar gjithashtu nëse intervistat po kryehen në njësinë e kampionimit primar të specifikuar).

### 1.3.5 Detaje të Tjera rreth Vrojtimit në Terren

Numri i pyetësorëve të regjistruar është plotësuar sipas kërkesave të kampionit të vrojtimit: 1260 pyetësorë gjithsej. Shkalla e refuzimit të intervistave raportohet të jetë në masën 27%, pra 340 vizitorë të intervistuar nuk kanë qenë të gatshëm të marrin pjesë në studim.

### 1.4 Limitet e Studimit

Gjatë kryerjes së vrojtimit të turistëve, intervistuesit dhe mbikëqyrësit e tyre, nuk identifikuan probleme të mëdha që mund të ndikonin në cilësinë e informacionit të grumbulluar. Pavarësisht kësaj, bazuar në raportet e përgatitura prej tyre lidhur me problemet e hasura nga intervistuesit gjatë kryerjes së punës në terren, rezultojnë këto gjetje kryesore:

- Në kuadër të problematikës së krijuar nga pandemia e COVID-19, dhe duke marrë parasysh vendimin e BE-së në lidhje me (mos)hapjen e kufijve ndërkombëtarë ndaj vendit tonë, vrojtimi i turistëve ndryshe nga vitet e mëparshme u shty dy javë më vonë nga planifikimi fillestar dhe u zhvillua gjatë datave 16-31 Gusht.
- Situata e shkaktuar prej COVID-19 ndikoi në një normë të lartë refuzimi nga turistët, kryesisht të huaj, për t'u përfshirë në vrojtim. Pavarësisht vështirësive, intervistuesit janë kujdesur që të ketë një përfaqësim, prej minimumi 30% turistë të huaj në secilën prej zonave turistike.

Këto limite apo vështirësi u tejkaluan me mbështetjen e koordinatorëve dhe sqarimeve të nevojshme nga intervistuesit sipas udhëzimeve përkatëse të përgatitur nga QSHKE.



## Kapitulli 2. Gjetjet e Vrojtimit të Turistëve 2020


Në këtë kapitull paraqitet analiza krahasuese ndërmjet viteve të ndërmarrjes së këtij studimi mbi kënaqësinë e turistëve lidhur me aspekte të ndryshme të qëndrimit të tyre në Shqipëri. Analiza krahasuese përfshin rezultatet e vrojtimit të turistëve në vitin 2020 me vrojtimitet e realizuara në vitet 2016, 2018, 2019. Për krahasueshmërinë e të dhënave, rezultatet janë përpunuar për të njëjtat destinacione turistike.

Në nën-çështjen e parë, jepet një përshkrim mbi profilin demografik të shembullit të vrojtimit. Informacionet e përfuara në këtë aspekt, lidhen me aspekte si: gjinia, grup-mosha, statusi i turistit, statusi i punësimit dhe niveli i arsimimit. Në nën-çështjen e dytë, paraqiten të dhënat për pikat hyrëse të përdorura nga turistët për të udhëtuar drejt Shqipërisë, koha e qëndrimit në vend, etj. Në nën-çështjen e tretë, detajohen rezultatet, që kanë të bëjnë me kënaqësinë e turistit. Së fundmi, në nën-çështjen e katërt, analizohet informacioni i grumbulluar mbi shpenzimet e turistëve në destinacionet, ku po zbatohet PZHIUT.

### 2.1 Profili Demografik i Turistëve

Në vrojtimin e realizuar në vitin 2020, 47% e turistëve janë femra dhe 53% meshkuj. Po njësoj, në studimin e vitit 2019, kemi një përfaqësi më të lartë të gjinisë mashkullore me 55%, kundrejt 45% femra. Ndryshe me studimin e vitit 2018, ku kemi një përfaqësim më të lartë të gjinisë femërore me 51% kundrejt 49% meshkuj. Grupmosha që preferon të udhëtojë në Shqipëri për vitin 2020 është 26-35 vjeç, (28.5%), e ndjekur nga 22.5% e turistëve në intervalin 36-45 vjeç, dhe 19% nga 18-25 vjeç. Shpërndarja e moshës është shumë e ngjashme krahasuar me vrojtimin e vitit 2019, 2018 dhe studimin bazë. Rezultatet paraqiten në Figurën I, si më poshtë.


Figura I. Turistët e intervistuar sipas gjinisë dhe grupmoshës 2016-2020



Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Një përmbledhje e rezultateve duke gjeneruar statusin e turistit, statusin e punësimit si dhe nivelin e arsimimit gjendet në Figurën 2. Rezultatet e vrojtimit për vitin 2020, tregojnë se 63% janë turistë ndërkombëtarë, pra është ulur përqindja e turistëve ndërkombëtarë (vizitorë të huaj dhe shqiptarë jo-rezident), krahasuar me vitin 2019, studimin e vitit 2018 dhe 2016 (në vitin 2019 - 74.8%; në vitin 2018 - 80% dhenë vitin 2016 - 64%). Si në studimet e viteve të mëparshme, në vrojtimin e vitit 2020 turistët u pyetën në lidhje me statusin e punësimit. 64% e turistëve të intervistuar deklaruan se janë të punësuar me kohë të plotë, 13% janë studentë, 11% të vetëpunësuar, 4% punë me kohë të pjesshme, dhe një pjesë pjesë e vogël e tyre janë në moshë pensioni. Një shpërndarje e tillë e statusit të punësimit, paraqitet pothuajse e njëjtë edhe në vrojtimit e vitit 2019, 2018 dhe studimin bazë. Përsa i përket nivelit të arsimimit, 51.6% e turistëve të intervistuar deklaruan se kanë përfunduar studimet universitare përkundrajt 52% në vitin 2019, dhe 44% në vrojtimin e vitit 2018. Në 2020 kemi një përfaqësim më të lartë të turistëve që kanë përfunduar arsimin e mesëm (28.8% e turistëve të intervistuar), krahasuar me 27% të një viti më parë, dhe 21% të dy viteve më parë.

Figura 2. Kategorizimi i turistëve sipas statusit të rezidentit, punësimit dhe arsimit 2016-2020




Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

## 2.2 Hyrja dhe Koha e Qëndrimit

Në vitin 2020, më shumë se 1/2 e turistëve (60%) kanë hyrë në territorin shqiptar nëpërmjet aeroportit, krahasuar me 55% në vitin 2019; 47% në vitin 2018 dhe me studimin bazë ku vetëm 25.7% e turistëve kanë përdorur këtë pikë hyrëse. Mënyra e dytë më e frekuentuar kanë qenë rrugët tokësore, kjo e pranuar nga 27.5% e turistëve kundrejt 28% një vit më parë, 35% dy vite më parë dhe 49% katër vite më parë. Në lidhje me rrugët detare, rezulton se është mënyra më pak e frekuentuar për të hyrë në territorin shqiptar (e pranuar nga 12.5% e turistëve).

Duke analizuar frekuencën e vizitave të turistëve të huaj në Shqipëri, jo domosdoshmërisht individët që kanë vizituar Shqipërinë, kanë vizituar edhe zonat turistike. Për këtë arsye, turistët janë pyetur nëse ishte hera e parë që vizitonin Shqipërinë (kjo pyetje ka qenë e vlefshme vetëm për vizitorët që nuk qëndrojnë në Shqipëri), si dhe nëse është hera e parë që vizitonin destinacionin ku janë pyetur (kjo pyetje ka qenë e vlefshme për të gjithë të intervistuarit). Në vitin 2020, është rritur përqindja e turistëve që pohojnë se e kanë vizituar më shumë se një herë Shqipërinë (nga 22% në 28%), dhe zonën turistike (nga 29.6% në 44%). Bazuar në diskutimet në grupe të fokusuara, pjesëmarrësit raportojnë se rritja e numrit të turistëve që vizitojnë Shqipërinë më shumë se një herë në vitin pandemik, është për shkak se ata e kanë vlerësuar Shqipërinë si një vend më të sigurt krahasuar me vendet e tjera të Evropës, dhe disa nga vizitorët shqiptarë që jetojnë jashtë janë kthyer për shkak të papunësisë që mund të kenë hasur gjatë kësaj periudhe pandemie. Rezultatet përmbledhen në Figurën 3.

Figura 3. Pikat hyrëse në Shqipëri dhe frekuenca e vizitave 2016-2020



Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Në vitin 2020, pjesa më e madhe e turistëve (56.4%), deklarojnë se qëndrojnë mesatarisht tetë ditë në Shqipëri. Krahasuar me vitin 2019 (57.7%) dhe 2018 (68%), vihet re një ulje e numrit të turistëve, që kanë qëndruar mesatarisht tetë ditë në Shqipëri. Koha e qëndrimit të turistëve në vend, është një tregues shumë i rëndësishëm i potencialit që ka Shqipëria për të ofruar për turistët, në terma aktiviteteve apo shërbimesh, por për vitin 2020 situata e shkaktuar në vend nga pandemia ka ndikuar në kohën e qëndrimit të turistëve në zonat turistike. Gjithashtu, një ulje e turistëve shihet dhe në kohën e qëndrimit një deri në tre ditë, krahasuar me studimin e vitit 2019, 2018 dhe studimin bazë. Ndërsa është rritur (41%) numri i turistëve që qëndrojnë për një afat ditor 4-7 ditë, krahasimisht me vitin 2019 (39.5%), vitin 2018 (25%) dhe vitin 2016 (33%).

**Tabela 1. Shpërndarja e turistëve sipas kohës së qëndrimit 2016-2020**

Kohëzgjatja e Qëndrimit	2016		2018		2019		2020	
	N	Përqindje	N	Përqindje	N	Përqindje	N	Përqindje
1-3 ditë	26	5%	102	8%	39	2.8%	32	2.5%
4-7 ditë	164	33%	320	25%	553	39.5%	517	41%
>= 8 ditë	323	62%	879	68%	808	57.7%	711	56.4%

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Kur flitet për kohëzgjatjen e qëndrimit në destinacionet e përfshira në studim, përlogaritjet janë bërë duke kombinuar dy pyetje: “Ju lutem më tregoni sa ditë keni qëndruar në këtë destinacion” dhe “Edhe sa ditë të tjera planifikoni të qëndroni në këtë destinacion”. Në vitin 2020, turistët janë më të prirur të qëndrojnë më gjatë në zonat bregdetare si Saranda (43% e tyre qëndrojnë më shumë se 8 ditë), krahasuar me destinacionet e tjera turistike. Gjithashtu, edhe në vitin 2019 turistët qëndronin më gjatë në zonën e Sarandës, në krahasim me vitet 2018 dhe 2016 ku turistët raportojnë se qëndrojnë më shumë në zona si Gjirokastra dhe Berati. Ky rezultat mund të shpjegohet me faktin se, vrojtimi u krye në gusht 2020, një periudhë kur turistët preferojnë të shkojnë në plazh dhe tërhiqen nga atraksionet e zonës bregdetare.


**Tabela 2. Koha e qëndrimit sipas destinacionit 2016, 2018, 2019 dhe 2020**

Viti	Kohëzgjatja e qëndrimit	1-3 ditë	4-7 ditë	>= 8 ditë
2016	Saranda – Shëtitorja	6 (7%)	35 (43%)	41 (50%)
	Gjirokastrë – Kalaja	4 (4%)	24 (24%)	71 (72%)
	Berat – Kalaja	6 (6%)	29 (31%)	60 (63%)
	Përmet - Qendra e qytetit	6 (11%)	9 (16%)	42 (74%)
	Syri i Kaltër	4 (5%)	35 (44%)	40 (51%)
	Porto Palermo	0 (0%)	32 (37%)	55 (63%)
2018	Saranda – Shëtitorja	21 (15%)	43 (31%)	74 (54%)
	Gjirokastrë – Kalaja	2 (2%)	22 (21%)	101 (77%)
	Berat – Kalaja	7 (5%)	38 (27%)	94 (68%)
	Përmet - Qendra e qytetit	12 (9%)	26 (20%)	95 (71%)
	Syri i Kaltër– Burim	13 (9%)	28 (20%)	99 (71%)
	Porto Palermo	1 (1%)	43 (32%)	88 (67%)
2019	Saranda – Shëtitorja	0 (0%)	39 (28%)	101 (72%)
	Gjirokastrë – Kalaja	4 (3%)	82 (58.5%)	54 (38.5%)
	Berat – Kalaja	4 (3%)	87 (62%)	49 (35%)
	Përmet - Qendra e qytetit	9 (6%)	71 (51%)	60 (43%)
2020	Saranda – Shëtitorja	0 (0%)	80 (57%)	60 (43%)
	Gjirokastrë – Kalaja	14 (10%)	80 (57%)	46 (33%)
	Berat – Kalaja	121 (86%)	18 (13%)	1 (1%)
	Përmet - Qendra e qytetit	113 (81%)	27 (19%)	0 (0%)

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Për vitin 2020, turistët janë pyetur nëse kanë ardhur nëpërmjet një pakete turistike apo në mënyrë të pavarur. 87.8% e tyre vizitonin Shqipërinë në mënyrë të pavarur, kundrejt 12.2% e turistëve që ishin pjesë e paketave turistike. Krahasuar me vitin 2019, kemi një ulje të numrit të turistëve që vizitojnë Shqipërinë në mënyrë të pavarur (nga 90.6% në vitin 2019, në 87.8% në vitin 2020). Kjo ulje tregon përmirësim të cilësisë dhe vlerës së paketave turistike, pavarësisht gjendjes së krijuar nga pandemia globale, COVID-19.

Figura 4. Lloji i turistëve 2016-2020



Ndërkombëtar	39.5%	60.5%	71.3%	28.7%	27.6%	72.4%	23.1%	76.8%

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Sinjalistika është vlerësuar më e lartë krahasuar me vitet e mëparshme (2.77 në vrojtimin bazë; 1.70 në studimin e vitit 2018 dhe 2.79 në studimin e vitit 2019) përveç në Porto Palermo dhe Orik.

**Tabela 40. Sinjalistika në zonat turistike**


(vlerësimi me një shkallë nga 1 në 4 ku 1="Shumë i pakënaqur" në 4="Shumë i kënaqur")

Destinacioni Turistik	Sinjalistika			
	2016	2018	2019	2020
Bënja- Ujërat Termal		1.41	3.03	3.21
Porto Palermo - Kalaja	3.10	1.75	2.81	3.04
Zvernec – Hyrja e Kishës		1.73	2.36	2.56
Orik – Qyteti i Lashtë		2.08	2.82	3.05
Syri i Kaltër- Burimi	2.47	1.53	2.90	3.09
<b>Totali</b>	<b>2.77</b>	<b>1.70</b>	<b>2.79</b>	<b>2.99</b>

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Turistët janë më të kënaqur në lidhje me sinjalistikën në zonat si Bënja (3.21) dhe Syri i Kaltër (3.09). Kënaqësia mbi sinjalistikën vlerësohet në vlera më të vogla nga turistët në zonën e Zvernecit (2.56).

**Figura 17. Sinjalistika në zonat turistike**



Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Përsa i përket statusit të turistëve, numri i turistëve vendas dhe ndërkombëtar, të cilët e vlerësojnë sinjalistikën “shumë mirë/ mirë”, është rritur krahasuar me një vit më parë, (Turistët vendas nga 67.2% në 89.2%; turistët ndërkombëtarë - nga 76.6% në 94.5%; Tabela 41 dhe tabela 42).

**Tabela 41. Sinjalistika disagreguar sipas statusit të turistëve 2016-2020**

Statusi	2016				2018			
	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë
Vendas	12.8%	17%	63.8%	6.4%	8.4%	33.5%	23.4%	34.7%
Ndërkombëtar	6.3%	13.9%	67.8%	12%	10.1%	28.7%	25.8%	35.4%
Statusi	2019				2020			
	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë
Vendas	9.7%	23.1%	43.4%	23.8%	10.8%	0.0%	66.0%	<b>23.3%</b>
Ndërkombëtar	6.0%	17.4%	54.2%	22.4%	5.5%	0.0%	73.0%	<b>21.5%</b>

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

**Tabela 42. Sinjalistika disagreguar sipas statusit të turistëve 2016-2020**

Statusi	2016		2018		2019		2020	
	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mirë	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mirë	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mire	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mirë
Vendas	29.8%	70.2%	41.9%	58.1%	32.8%	<b>67.2%</b>	10.8%	<b>89.2%</b>
Ndërkombëtar	20.2%	79.8%	38.8%	61.2%	23.4%	<b>76.6%</b>	5.5%	<b>94.5%</b>

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

### 2.3.3.3 Niveli i Pastërtisë në Zonë, Cilësia dhe Disponueshmëria e Pajisjeve Sanitare

Turistët janë pyetur mbi kënaqësinë e tyre rreth nivelit të pastërtisë. Në total, krahasuar me një vit më parë vlera e nivelit të pastërtisë është ulur lehtë (nga 3.30 në 3.21). Krahasuar me studimin e vitit 2019, niveli i pastërtisë është rritur në zonën e Zvërnecit (nga 3.14 në 3.21) por është ulur lehtë në zonat turistike si Bënja, Porto Palermo, Orik dhe Syri i Kaltër.


**Tabela 43. Niveli i Pastërtisë në zonat turistike**

(vlerësimi me një shkallë nga 1 në 4 ku 1="Shumë i pakënaqur" në 4="Shumë i kënaqur")

Destinacioni Turistik	Niveli i Pastërtisë			
	2016	2018	2019	2020
Bënja- Ujërat Termal		1.80	3.07	2.90
Porto Palermo - Kalaja	2.94	1.58	3.29	3.14
Zvernec – Hyrja e Kishës		1.9	<b>3.14</b>	<b>3.21</b>
Orik – Qyteti i Lashtë		2.37	3.60	3.56
Syri i Kaltër- Burimi	2.81	1.48	3.41	3.24
<b>Totali</b>	<b>2.87</b>	<b>1.88</b>	<b>3.30</b>	<b>3.21</b>

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Figura 18. Niveli i Pastërtisë në zonat turistike



Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Krahasuar me një vit më parë, turistët ndërkombëtar dhe vendas janë më pak të kënaqur se një vit më parë rreth nivelit të pastërtisë. Në studimin e vitit 2020, rezulton se 77.7 % e turistëve vendas vlerësojnë nivelin e pastërtisë shumë mirë/ mirë krahasuar me 78.1 % e turistëve ndërkombëtarë.

Tabela 44. Niveli i Pastërtisë disagreguar sipas statusit të turistëve 2016-2020

Statusi	2016				2018			
	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë
Vendas	6.3%	21.1%	66.3%	6.3%	8.4%	33.5%	23.4%	34.7%
Ndërkombëtar	3.6%	14.5%	64.2%	17.6%	10.1%	28.7%	25.8%	35.4%

Statusi	2019				2020			
	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë
Vendas	2.3%	14.3%	44.1%	39.3%	3.8%	18.5%	32.3%	45.4%
Ndërkombëtar	0.7%	14.6%	33.4%	51.3%	2.6%	19.3%	25.7%	52.4%

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Tabela 45. Niveli i Pastërtisë disagreguar sipas statusit të turistëve 2016-2020

Statusi	2016		2018		2019		2020	
	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mirë	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mirë	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mire	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mirë
Vendas	27.4%	72.6%	41.9%	58.1%	16.6%	83.4%	22.3%	77.7%
Ndërkombëtar	18.1%	81.9%	38.8	61.2%	15.3%	84.7%	21.9%	78.1%

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Në vlerat nga 1 (shumë i pakënaqur) te 4 (shumë i kënaqur), cilësia dhe disponueshmëria e objekteve sanitare, në vitin 2020 është vlerësuar 3.13 në total, e cila është rritur krahasuar me vitin 2019. Nga figura 19 vihet re se në të gjitha destinacionet turistike cilësia dhe disponueshmëria e objekteve sanitare është rritur krahasuar me vitin 2019, studimin e vitit 2018 dhe 2016.


Tabela 46. Cilësia dhe disponueshmëria e objekteve sanitare në zonat turistike

(vlerësimi me një shkallë nga 1 në 4 ku 1="Shumë i pakënaqur" në 4="Shumë i kënaqur")

Destinacioni Turistik	Cilësia dhe disponueshmëria e objekteve sanitare				
	2016	2018	2019	2020	2020
Bënja- Ujërat Termal		1.17	2.93	3.09	
Porto Palermo - Kalaja	2.64	1.47	2.81	3.01	
Zvernec – Hyrja e Kishës		1.5	2.41	2.59	
Orik – Qyteti i Lashtë		1.57	3.36	3.52	
Syri i Kaltër- Burimi	2.48	1.46	3.29	3.45	
<b>Totali</b>	<b>2.58</b>	<b>1.41</b>	<b>2.96</b>	<b>3.13</b>	

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Figura 19. Cilësia dhe disponueshmëria e objekteve sanitare në zonat turistike



Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Në lidhje me cilësinë dhe disponueshmërinë e objekteve sanitare disagreguar me statusin e turistëve, rezultatet paraqesin një rritje krahasuar me studimet e viteve të mëparshme. Për vitin 2020, turistët ndërkombëtar e vlerësojnë më pozitivisht cilësinë dhe disponueshmërinë e objekteve sanitare krahasuar me turistët vendas (93.2% përkundrejt 86.2%).

Tabela 47. Cilësia dhe disponueshmëria e objekteve sanitare disagreguar sipas statusit të turistëve 2016-2020

Statusi	2016				2018			
	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë
Vendas	20.7%	27.6%	44.8%	6.9%	67.7%	27.5%	4.8%	0%
Ndërkombëtar	10.8%	15.7%	63.9%	9.6%	63.7%	32.5%	3.8%	0%

Statusi	2019				2020			
	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë
Vendas	14.3%	18.3%	38.6%	28.8%	13.8%	0.0%	54.1%	32.1%
Ndërkombëtar	7.4%	16.4%	41.1%	35.1%	6.8%	0.0%	56.3%	37.0%

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Tabela 48. Cilësia dhe disponueshmëria e objekteve sanitare disagreguar sipas statusit të turistëve 2016 - 2020

Statusi	2016		2018		2019		2020	
	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mirë	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mirë	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mire	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mirë
Vendas	48.3%	51.7%	95.2%	4.8%	32.6%	67.4%	13.8%	86.2%
Ndërkombëtar	26.5%	73.5%	96.2%	3.8%	23.8%	76.2%	6.8%	93.2%

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

### 2.3.3.4 Fasilitete për Fëmijë


Për vitin 2020, ka një përmirësim të kënaqësisë së turistëve mbi ambientet argëtuese për fëmijë në zonat turistike ku po zbatohet projekti. Në vitin 2020 turistët shprehen me një kënaqësi më shumë se vlera 2.92. Rezultatet më të larta kanë turistët e pyetur në Bënjë dhe Porto Palermo. Turistët e pyetur në Syri i Kaltër e vlerësojnë më negativisht cilësinë e ambienteve për fëmijët krahasuar me destinacionet e tjera turistike (2.91; Figura 20).

**Tabela 49. Fasilitete për fëmijë në zonat turistike**

Destinacioni Turistik	Fasilitete për fëmijë			
	2016	2018	2019	2020
Bënja- Ujërat Termal		1.02	2.31	2.94
Porto Palermo – Kalaja	2.79	1.05	2.52	2.94
Zvernec – Hyrja e Kishës		1.26	2.40	2.91
Orik – Qyteti i Lashtë		1.22	2.69	2.93
Syri i Kaltër- Burimi	2.78	1.06	2.75	2.89
<b>Totali</b>	<b>2.78</b>	<b>1.12</b>	<b>2.53</b>	<b>2.92</b>

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

**Figura 20. Fasilitete për fëmijë në zonat turistike**



Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Siç tregohet në tabelën 50 dhe tabelën 51, për vitin 2020 turistët ndërkombëtarë janë më të kënaqur se vendasit mbi ambientet argëtuese për fëmijët. 86.2% e turistëve ndërkombëtar vlerësojnë fasilitetet për fëmijët “ mirë/ shumë mirë” krahasuar me 82.1% e turistëve vendas. Vlen të theksohet se, krahasuar me studimin e vitin 2019, si turistët ndërkombëtarë dhe ata vendas e vlerësojnë më pozitivisht cilësinë e ambienteve argëtuese për fëmijët.

**Tabela 50. Fasilitete për fëmijë disagreguar sipas statusit të turistëve 2016-2020**

Statusi	2016				2018			
	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë
Vendas	7%	16.3%	74.4%	2.3%	9.6%	34.7%	35.9%	19.8%
Ndërkombëtar	8.2%	11.5%	70.5%	9.8%	12.5%	24.6%	44.9%	18.0%

Statusi	2019				2020			
	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë	Shumë keq	Keq	Mirë	Shumë mirë
Vendas	23.5%	34.1%	29.1%	13.3%	0.5%	17.3%	73.3%	8.8%
Ndërkombëtar	13.4%	21.0%	54.4%	11.2%	0.0%	13.8%	77.1%	9.0%

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

**Tabela 51. Fasilitete për fëmijë disagreguar sipas statusit të turistëve 2016 - 2020**

Statusi	2016		2018		2019		2020	
	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mirë	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mirë	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mire	Shumë keq/ Keq	Mirë/ Shumë mirë
Vendas	23.3%	76.7%	44.3%	55.7%	57.6%	42.4%	17.9%	82.1%
Ndërkombëtar	19.7%	80.3%	37.1%	62.9%	34.4%	65.6%	13.8%	86.2%

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

## 2.4 Informacioni mbi Shpenzimet e Turistëve

Për të analizuar vlerën reale të përvojës turistike është e nevojshme të bëjmë një llogaritje financiare mbi shpenzimet e turistëve gjatë kohës së tyre të qëndrimit në zonat turistike të marra në studim. Analiza e vlerës monetare të shpenzuar është bërë nëpërmjet përlllogaritjes financiare të

shpenzimeve mesatare të turistëve, përfshirë: koston e paketës turistike, akomodimin, ushqimin, transportin dhe aktivitete të tjera. Sipas rezultateve të paraqitura në tabelën e mëposhtme, në vitin 2020 një turist ka shpenzuar mesatarisht 46.68 Euro/ ditë, e cila në krahasim me vitin 2019, ka pësuar rënie prej 0.63 Euro/ditë të shpenzimeve mesatare ditore (ishte 48.82 Euro/ ditë).

**Tabela 52. Shpenzimet mesatare të turistëve në ditë 2016-2020 (EUR)**

Destinacioni Turistik	Mesatare 2016	Mesatare 2018	Mesatare 2019	Mesatare 2020
Saranda – Shëtitorja	102.53	76.79	50.50	48.21
Gjirokastër – Kalaja	36.01	71.14	49.30	42.43
Berat- Kalaja	32.23	44.41	45.06	41.97
Përmet- Qendra e Qytetit	13.68	41.64	39.05	43.94
Syri i Kaltër- Burimi	60.23	39.27	49.49	45.44
Porto Palermo- Kalaja	21.38	45.64	51.79	49.66
Bënja- Ujërat Termal		39.27	49.89	47.51
Zvërnec- Hyrja e Kishës		59.88	47.32	52.29
Orik – Qyteti i Lashtë		60.66	54.43	48.64
<b>Total</b>	<b>44.49</b>	<b>53.14</b>	<b>47.31</b>	<b>46.68</b>

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Për sa i përket analizës gjinore për vitin 2020, mund të arrijmë në konkluzionin që femrat në përgjithësi kanë shpenzime ditore më të larta se meshkujt në zonat turistike përkatës me përjashtim të zonave si Berati, Permeti, Bënja dhe Zvërneci, tek të cilat rezultojnë turistet femra me shpenzime më të ulëta se turistët meshkuj. Megjithatë, shpenzimet midis turistëve meshkuj dhe femra kanë diferenca shumë të vogla (Tabela 53).

**Tabela 53. Shpenzimet mesatare të turistëve në ditë 2016-2020 (EUR)**

Destinacioni turistik	Gjinia	Mesatare 2016	Mesatare 2018	Mesatare 2019	Mesatare 2020
Saranda – Shëtitorja	Meshkuj	129.74	81.16	52.58	47.06
	Femra	61.73	72.54	48.93	49.75
	<b>Totali</b>	<b>102.53</b>	<b>76.79</b>	<b>50.50</b>	<b>48.21</b>
Gjirokastër – Kalaja	Meshkuj	34.85	70.29	54.04	39.02
	Femra	37.53	71.97	44.82	46.02
	<b>Totali</b>	<b>36.01</b>	<b>71.14</b>	<b>49.30</b>	<b>42.42</b>
Berat – Kalaja	Meshkuj	38.51	41.05	45.53	42.98
	Femra	23.92	47.08	44.50	41.11
	<b>Totali</b>	<b>32.23</b>	<b>44.41</b>	<b>45.06</b>	<b>41.97</b>
Përmet – Qendra e qytetit	Meshkuj	17.44	44.25	39.63	45.51
	Femra	11.28	39.39	38.36	42.61
	<b>Totali</b>	<b>13.68</b>	<b>41.64</b>	<b>39.05</b>	<b>43.94</b>
Syri i Kaltër – Burimi	Meshkuj	60.75	40.11	48.82	45.07
	Femra	58.39	38.43	50.43	45.68
	<b>Totali</b>	<b>60.23</b>	<b>39.27</b>	<b>49.49</b>	<b>45.44</b>
Porto Palermo – Kalaja	Meshkuj	21.01	48.49	53.07	45.77
	Femra	22.06	41.49	49.91	52.33
	<b>Totali</b>	<b>21.38</b>	<b>45.64</b>	<b>51.79</b>	<b>49.66</b>
Bënja- Ujërat Termalë	Meshkuj		40.11	51.12	48.29
	Femra		38.43	48.00	46.55
	<b>Totali</b>		<b>39.27</b>	<b>49.89</b>	<b>47.51</b>
Zvërnec – Hyrja e Kishës	Meshkuj		57.9	47.46	54.73
	Femra		61.91	47.21	50.23
	<b>Totali</b>		<b>59.88</b>	<b>47.32</b>	<b>52.29</b>
Orik – Qyteti Antik	Meshkuj		58.11	52.43	46.98
	Femra		63.21	56.80	49.81
	<b>Totali</b>		<b>60.66</b>	<b>54.43</b>	<b>48.64</b>
<b>Totali</b>		<b>44.49</b>	<b>53.14</b>	<b>47.31</b>	<b>46.68</b>

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Një analizë e statusit të turistit tregon se në vitin 2020 në pjesën më të madhë të zonave turistike, turistët ndërkombëtarë shpenzojnë mesatarisht më shumë në krahasim me turistët

vendas, me përjashtim të zonës së Sarandës, Përmetit dhe Porto Palermos, ku turistët vendas janë ata që shpenzojnë më shumë se turistët ndërkombëtarë. Nga analiza e statusit të turistit për vitin 2020 rezulton se shuma më e lartë e shpenzuar mesatarisht ka qënë në Syri i Kaltër prej turistëve ndërkombëtarë në vlerën e 50.63 Euro/ ditë, ndërkohë që për të njëjtën zonë turistike, turistët vendas të intervistuar kanë deklaruar se kanë shpenzuar mesatarisht 47.01 Euro/ ditë, pra afërsisht 7.7 % më pak sesa turistët ndërkombëtarë. Diferenca më e madhe sipas statusit të turistit vihet re në Berat – Kalaja, ku turistët ndërkombëtarë kanë shpenzuar 12.4 % më shumë sesa turistët vendas (Tabela 54).

**Tabela 54. Shpenzimet mesatare të turistëve në ditë sipas statusit të turistit 2016-2020(EUR)**

Destinacioni turistik	Statusi i turistit	Mesatarja 2016	Mesatarja 2018	Mesatare 2019	Mesatare 2020
Saranda – Shëtitorja	Vendas	61.97	63.67	45.78	48.95
	Ndërkombëtar	126.28	78.36	53.20	47.34
	<b>Totali</b>	<b>102.53</b>	<b>76.79</b>	<b>50.50</b>	<b>48.21</b>
Gjirokastrë – Kalaja	Vendas	13.40	62.67	45.66	40.67
	Ndërkombëtar	42.58	72.16	51.52	45.49
	<b>Totali</b>	<b>36.01</b>	<b>71.14</b>	<b>49.30</b>	<b>42.43</b>
Berat – Kalaja	Vendas	3.82	80.00	38.13	40.22
	Ndërkombëtar	42.73	44.15	50.89	45.22
	<b>Totali</b>	<b>32.40</b>	<b>44.41</b>	<b>45.06</b>	<b>41.97</b>
Përmet – Qendra e qytetit	Vendas	0.00	33.33	34.66	45.18
	Ndërkombëtar	30.39	44.52	41.72	41.25
	<b>Totali</b>	<b>13.50</b>	<b>41.64</b>	<b>39.05</b>	<b>43.94</b>
Syri i Kaltër – Burimi	Vendas	31.30	30.02	45.90	47.01
	Ndërkombëtar	79.80	43.23	51.36	50.63
	<b>Totali</b>	<b>60.70</b>	<b>39.27</b>	<b>49.49</b>	<b>48.64</b>
Porto Palermo – Kalaja	Vendas	2.02	45.53	49.62	49.86
	Ndërkombëtar	30.40	45.7	53.67	49.40
	<b>Totali</b>	<b>21.16</b>	<b>45.64</b>	<b>51.79</b>	<b>49.66</b>
<b>Totali</b>		<b>44.49</b>	<b>53.15</b>	<b>47.31</b>	<b>46.68</b>

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Për të kuptuar se si kanë ndikuar ndërhyrjet e realizuara deri në kohën e realizimit të këtij studimi, turistët u pyetën se si e vlerësonin qëndrimin e tyre në Shqipëri ku ata vlerësuan me 1 - Shumë të pakënaqur, 2 - Të pakënaqur, 3 - Neutral, 4 - Të kënaqur dhe 5 - Shumë të kënaqur. Me qëllim analizimit të numrit të turistëve në vlerë absolute, janë përjashtuar ata turistë që janë përgjigjur si Neutral. Në vitin 2019 janë 1050 turistë të cilët deklarojnë se janë “shumë të kënaqur/ të kënaqur” me qëndrimin e tyre në Shqipëri dhe 72 të intervistuar deklarojnë se janë “shumë të pakënaqur/ të pakënaqur”. Ndërkohë në vitin 2020 janë 1084 të cilët pohojnë se janë “shumë të kënaqur/ të kënaqur” dhe 93 turistë të cilët janë “shumë të pakënaqur/ të pakënaqur”. Pra, kemi një rritje prej 3.2 % të turistëve që shprehen se janë të kënaqur.

**Tabela 55. Shpërndarja e turistëve sipas vlerësimit të kënaqësisë në lidhje me qëndrimin e tyre në Shqipëri**

	2018	2019	2020
<b>Shumë të pakënaqur</b>	16	16	27
<b>Të pakënaqur</b>	52	56	66
<b>Neutral</b>	179	138	83
<b>Të kënaqur</b>	<b>602</b>	<b>695</b>	<b>687</b>
<b>Shumë të kënaqur</b>	<b>411</b>	<b>355</b>	<b>397</b>
<b>Totali</b>	1260	1260	1260

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

**Tabela 56. Shpërndarja e turistëve sipas vlerësimit të kënaqësisë në lidhje me qëndrimin e tyre në Shqipëri**

	2018	2019	2020
<b>Të pakënaqur</b>	68	72	93
<b>Neutral</b>	179	138	83
<b>Të kënaqur</b>	1013	1050	1084
<b>Totali</b>	1260	1260	1260

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020

Duke konsideruar një nga komponentët e projektit, që lidhet me fuqizimin e biznesit vendor, intervistuesit kanë numëruar bizneset e pranishme (formale dhe informale) në zonat e studiuara. Kjo kategori do të jetë targeti kryesor në vërtetimin e biznesit në vitet në vijim. Një numër i përafërt, tregohet në Tabelën 57 si më poshtë. Krahasuar me një vit më parë, vërehet një ulje të numrit të bizneseve në Sarandë (nga 52 biznese në vitin 2019, në 43 biznese në vitin 2020), në Gjirokastrë (nga 22 biznese në vitin 2019 në 20 biznese në vitin 2020), në Berat (nga 32 biznese në vitin 2019 në 30 biznese në vitin 2020). *Ulja e numrit të bizneseve në destinacionet turistike lidhet me situatën e shkaktuar prej pandemisë globale COVID-19, rezultat i mbështetur dhe nga diskutimet në grupet e fokusuar.*

**Tabela 57. Numri i bizneseve lidhur me turizmin 2018, 2019 dhe 2020**

Nr.	Destinacioni turistik	Numri i Bizneseve 2018	Numri i Bizneseve 2019	Numri i Bizneseve 2020
1	Sarandë- Shëtitorja	47	52	43
2	Gjirokastrë – Kalaja	18	22	20
3	Berat – Kalaja	38	32	30
4	Përmet – Qendra e qytetit	10	9	9
5	Bënjë – Ujërat Termal	0	0	0
6	Porto Palermo – Kalaja	6	5	4
7	Zvernec – Hyrja e Kishës	7	8	9
8	Orik - Qyteti Antik	8	8	8
9	Syri Kaltër – Burimi	6	4	4

Burimi: Databaza 2016; ACER, Studimi 2018, 2019 dhe 2020



## Kapitulli 3. Përmbledhja e Gjetjeve mbi Studimin Cilësor

### 3.1 Metodologjia e Studimi Cilësor

Studimi cilësor kishte si qëllim zhvillimin e diskutimeve në grupe të fokusuar me objektiv kryesor ndarjen e gjetjeve paraprake që kanë dalë nga studimi sasior “Vrojtimi i turistëve” të zhvilluar në datën 16-31 Gusht 2020, si dhe marrjen e të dhënave më të thelluara nga aktorë të përfshirë në zhvillimin e turizmit në zona specifike.

Studimi cilësor është kryer në zonën e Shqipërisë së Jugut, më konkretisht në katër bashki ku ka pasur dhe parashikohet të ketë ndërhyrje nga projekti: Berat, Përmet, Gjirokastrë dhe Sarandë. Këto katër bashki ishin përcaktuar paraprakisht nga FSHZH. Katër diskutime në grup të fokusuar janë zhvilluar në këto qytete me qëllim diskutimin më të thelluar për disa gjetje të studimit sasior si dhe marrjen e informacionit shtesë dhe opinionëve, sugjerimeve të tyre për situatën aktuale dhe për mundësinë e përmirësimit. Diskutimet në grupet e fokusuar u zhvilluan me familjarë, përfaqësues të bizneseve si dhe përfaqësues të njësive të pushtetit vendor. Gjatë diskutimeve, pjesëmarrësit u inkurajuan për të dhënë opinionet e tyre mbi ecurinë e zbatimit të projektit dhe ndikimin në zhvillimin e turizmit, si dhe për të identifikuar problematikat kryesore. Të gjithë pjesëmarrësit u pajisën me anë të e-mailit me materiale informuese, më konkretisht:

- Agjenda e takimit
- Informacion mbi Projektin
- Listë me pyetje orientuese

### 3.2 Limitet e Studimit cilësor

Ndryshe nga vitet e mëparshme, diskutimet në grupet e fokusuar u mbajtën online me anë të platformës “Zoom Meeting” në respektim të protokollit të masave anti COVID-19. Kontakti dhe shpërndarja e informacionit ka qenë nëpërmjet e-mailit. Por kjo nuk ka ndikuar në zhvillimin e diskutimeve në grupe të fokusuar dhe në numrin e pjesëmarrësve në të katërta takimet online.

### 3.3 Gjetjet e Diskutimeve në Grupe të Fokusuar

Si pjesë e studimit cilësor, katër diskutimet në grup të fokusuar u zhvilluan me 59 individë. Qëllimi i realizimit të grupeve të fokusuar ishte mbledhja e mendimeve shtesë mbi disa aspekte të zbatimit të projektit dhe ndikimin që ky i fundit ka patur në jetën e komunitetit. Tabela më poshtë paraqet vendin, datën e zhvillimit të çdo takimi online si dhe pjesëmarrësit në secilin takim.

Tabela 58. Të dhëna për Diskutimet në Grup të Fokusuar

Vendndodhja	Data	Ora	Nr. i pjesëmarrësve
Përmet	30/09/2020	09:30	15
Gjirokastrë	30/09/2020	12:00	14
Berat	02/10/2020	09:00	16
Sarandë	02/10/2020	11:30	14
<b>Totali</b>			<b>59</b>

Burimi: ACER, Studimi 2020, Viti III

Sipas diskutimeve në grupet e fokusuara rezultoi se turizmi në vitin 2020 ka pasur vështirësi për shkak të pandemisë globale. Dy ngjarje të rëndësishme që kanë prekur Shqipërinë gjatë viteve 2019-2020, si tërmeti i datës 26 Nëntor dhe pandemia globale (karantinimi), kanë ndikuar në vazhdimin e zbatimit të projektit. Nga të katërta takimet zbatimi i projektit ka rezultuar më shumë pozitivisht në bashkinë e Beratit, ndërkohë pjesëmarrësit e tre bashkive të tjera pohojnë se ka pasur ndërhyrje por presin akoma shumë.

Pjesëmarrësit theksojnë se vlerësimi i turizmit në vitin 2020, duhet të merret me limite për shkak të pandemisë, dhe nuk mund të bëhet krahasimi me vitet e mëparshme sepse ky vit nuk ka qenë në të njëjtat kushte si vitet e tjera. Lloji i turistëve këtë vit, ka qenë po ashtu shumë ndryshe nga vitet e mëparshme për shkak të mbylljes së kufijve. Katër bashki theksojnë se kanë pasur një numër të madh turistësh vendas dhe bizneset apo institucione të tjera që ofrojnë shërbime të turizmit i ka kapur kjo gjë të pa përgatitur. Turistët vendas kanë kërkesa të ndryshme nga turistët ndërkombëtar, duke ndikuar në aktivitetet dhe shërbimet e ofruara. Gjithashtu vlen të theksohet se, këtë vit lloji i turistëve ka qenë kryesisht i pavarur dhe jo me agjenci turistike plus fakti që turistët kanë qenë vendas, ka sjell si pasojë uljen e kohëzgjatjes së qëndrimit në zonat turistike.

*Strukturat akomoduese dhe Infrastruktura* në lagjet kryesore në të katërta qytetet është vlerësuar pozitivisht dhe kjo falë projektit për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turizmin. Por, ashtu si vitin e kaluar duhet të ketë ndërhyrje në infrastrukturë që lidh qendrën e qyteteve me zonat turistike ose me fshatrat (*rruga që lidh Përmetin me fshatin Leuzë, me Bënjën; mungesa e unazës në qytetin e Gjirokastrës*). Sipas pjesëmarrësve, infrastruktura e keqe bën që të mos shfrytëzohen plotësisht potencialet e çdo vendi duke ndikuar negativisht dhe në kënaqësinë e turistëve.

Në bazë të studimit sasior, turistët janë shprehur kryesisht të pakënaqur në lidhje me transportin publik vendor në çdo qytet, si pasojë e cilësisë së transportit dhe mungesa e tabelave që çdo turist të informohet në lidhje me oraret. Nga diskutimet në grupet e fokusuara u pohua fakti se masat e marra nga Covid -19 kanë prekur transportin publik dhe kjo duhet të ketë ndikuar dhe në kënaqësinë e turistëve mbi këtë shërbim.

“Bashkia ka ndërmarrë një hulumtim mbi strukturat akomoduese në qytetin e Gjirokastrës, i cili vazhdon akoma. Nga gjetjet, shqetësuese është se rreth 60% e bizneseve rezultojnë të mbyllura/pa punë për shkak të situatës së pandemisë.”

Bashkia, Gjirokastrë

“Duhet të arrihet një bashkëpunim midis pushtetit lokal dhe operatorëve të tjerë si privat dhe publik, në të mirën e turizmit dhe jo në të mirat individuale.”

Guidë, Përmet

Nga takimet online rezultoi se realisht turistët mund të kalojnë më shumë ditë cilësore në vend. Pjesëmarrësit renditën disa arsye, që çojnë në qëndrimin e shkurtër të turistëve:

Promovimi: Në diskutimet e zhvilluara në të katërta qytetet, u shpreh një nevojë e menjëhershme për krijimin e “Organizimit të Menaxhimit të Destinacionit”<sup>17</sup> ku të promovohen zonat turistike për çdo vend specifik. Në këtë mënyrë turisti informohet në lidhje me çfarë ofron çdo qytet (kisha, muze, plazhe, peizazhe apo zona turistike afër qytetit) dhe zgjedh t’i vizitojë ose jo ato. Të dhënat nga studimi cilësor tregojnë se bashkia e Gjirokastrës ka një promovim më të zhvilluar të vendit dhe destinacioneve të saj turistike kjo falë faqes në web “Visit Gjirokastra”.<sup>18</sup>

“Bashkia e Beratit ka një grup shumë të mire pune të specializuar në fushën e turizmit, dhe ju premtoj që vitin e ardhshëm bashkia e Beratit do të ketë promovimin më të mirë online krahasuar me bashkitë e tjera në Shqipëri.”

Bashkia, Berat

Aktivitetet në qytete: Për vitin 2020 është shprehur një mungesë e aktiviteteve për shkak të të pandemisë globale. Aktivitetet e muzikore kanë munguar dhe disa aktivitete që janë mbajtur janë bërë me masa të rrepta, me shumë pak njerëz, për të respektuar protokollin anti Covid-19. Baret dhe restorantet kanë qenë të hapur vetëm për tavolinat jashtë. Pra, ka qenë e vështirë të ofrohen një sërë aktiviteteve dhe kjo është ndjerë kryesisht në zonën e Gjirokastrës, Beratit dhe Përmetit. Mungesa e aktiviteteve në zonën e Sarandës nuk është ndjerë shumë nga turistët në zonën e Sarandës për shkak të bregdetit.

Infrastruktura: Lë ende për të dëshiruar infrastruktura rrugore që lidh zonat kryesore me kishat, kalatë (e pranuar nga pjesëmarrësit në zonën e Gjirokastrës), rrugët që lidhin qytetin me fshatrat (e pranuar nga pjesëmarrësit në zonën e Përmetit). Pjesëmarrësit në takimin online në zonën e Beratit shprehën se infrastruktura rrugore që lidh qytetin me fshatrat është përmirësuar dhe do vazhdojë të përmirësohet në vitet në vazhdim.

Parkimi dhe mbetjet: Parkimi vazhdon të mbetet një problematikë në të katërta bashkitë, por jo vetëm për turistët edhe për vendasit. Pastrimi i vendit ishte një problematikë tjetër, e shprehur kryesisht në bashkinë e Përmetit, ndërkohë përfaqësues nga bashkia e Beratit shprehu si problematikë kryesore qentë e rrugës dhe pushteti vendor duhet të merrte një masë për këtë problematikë.

Zonat rekreative: Pjesëmarrësit në takimet online në zonën e Gjirokastrës dhe Sarandës sollën në vëmendje mungesën e zonave rekreative. Mungesa e zonave pushuese për fëmijët dhe moshën e rritur e vonë sillte një kënaqësi të ulët për turistët.

Përfaqësues nga bashkitë, në të katërta diskutimet online theksuan faktin se fluksi i turistëve këtë vit ishte vërtetë më i ulët në shifër krahasuar me vitet e mëparshme. Matja e fluksit të turistëve në secilin prej qyteteve nuk reflekton numrin e vërtetë të turistëve, pasi ky numër matet ose me numrin e biletave të shitura në Kala/Muzeume/Shtëpi Kulture. Për vitin 2020 është e vështirë të flasim edhe për cilësinë e guidave turistike, sepse kanë punuar shumë pak guida dhe kjo si rezultat i situatës të shkaktuar nga pandemia. Në [Aneksin 2](#) jepen gjetjet e detajuara nga grupet e fokusuara për secilën nga bashkitë: Berati, Përmeti, Gjirokastra dhe Saranda.

<sup>17</sup> Organizimi i Menaxhimit të Destinacionit: <https://dmoalbania.al/>

<sup>18</sup> Visit Gjirokastra: <https://www.visit-gjirokastra.com/>

Nga grupet e fokusuar rezultuan disa shqetësime të përbashkëta të familjarëve dhe bizneseve vendore. Tabela 59 paraqet në mënyrë të përmbledhur barrierat e përbashkëta në Berat, Përmet, Gjirokastër dhe Sarandë, si dhe zgjidhjet e propozuara.

**Tabela 59. Barrierat e përbashkëta dhe zgjidhjet përkatëse në secilin qark**

<b>BARRIERA TË PËRBASHKËTA</b>	<b>ZGJIDHJET E PROPOZUARA</b>
<b>Bashkëpunimi me pushtetin vendor</b>	Bashkëpunim i pushtetit vendor me aktorë të ndryshëm privat të përfshirë në turizmin e vendit në mënyrë që zgjidhen problemet e përbashkëta, jo në mënyrë individuale dhe kështu arrihet një zhvillim i qëndrueshëm i turizmit në vend.
<b>Promovimi i destinacioneve</b>	Promovimi i destinacionit dhe krijimi i “Organizimi i Menaxhimit të Destinacionit” duhet të shihet me seriozitet nga pushteti vendor dhe PZHIUT.
<b>Zonat Rekreative</b>	Sa më shumë zona të gjelbërta dhe kënde lojërash për fëmijë të ketë një vend, aq më shumë tërheq turistët familjarë dhe moshën e rritur e vonë.
<b>Investimet në infrastrukturë rrugore</b>	Rritja e investimeve në përmirësimin e rrugëve që çojnë turistët në pikat kyce turistike dhe në fshatrat turistike.
<b>Mbetjet</b>	Pastrimi i qytetit dhe fshatrave, në mënyrë që të tërheq sa më shumë turistë dhe zgjidhja e problematikës me qentë e rrugës.
<b>Parkimi</b>	Krijimi i ambienteve të reja për parkim, në mënyrë që turistët ta kenë më të lehtë hyrjen në qytet me makinë personale.

Burimi: ACER, Studimi 2020, Viti III

## Kapitulli 4. Numërimi i Turistëve

### 4.1 Metodologjia e Përdorur mbi Numërimin e Turistëve

Bazuar në literaturë, për monitorimin e vizitorëve në zonat turistike ekzistojnë metoda të ndryshme. Të tilla metoda përfshijnë i) observimin direkt, ii) observimin nëpërmjet videos, iii) pajisjet e numërimit, iv) librat e regjistrimit, v) intervista etj. Vlen të theksohet se shumica e këtyre metodave dhe instrumentave njihen në Shqipëri dhe është e pamundur të përdoren për shkak të kostos së tyre të lartë. Në morinë e metodave ekzistuese, duke marrë parasysh edhe metodën e përdorur në studimin bazë të vitit 2016, në vitin e parë të studimit, viti 2018 dhe në vitin e dytë të studimit 2019 (metoda e numërimit të turistëve në kohë reale në të njëjtën ditë dhe orë, në 9 zonat e përzgjedhura turistike), e njëjta metodë është përdorur edhe në studimin e vitit 2020. Përgjatë zhvillimit të punës në terren, intervistuesit u kujdesën që të numëronin fluksin e turistëve në zonën e marrë në studim. Në Tabelën 59, si më poshtë paraqitet numri mesatar i turistëve në shtatë ditë të javës. Theksohet se ky numër nuk tregon me saktësi numrin e turistëve, që kanë qëndruar në zonë, por një numër të përafërt të trendit ditor.

### 4.2 Gjetjet mbi Numërimin e Turistëve

Ashtu si në vrojtimit e viteve të mëparshme, në zonat e studiuara, fluksin më të madh e kanë zonat bregdetare duke marrë parasysh edhe periudhën gjatë realizimit të vrojtimit (muaji Gusht). Për vitin 2020 Saranda (m=1000), Syri i Kaltër (m=201), Zvërneci (m=125) dhe Kalaja në Gjirokastrë (m=125) janë zonat me mesatare më të lartë të numrit të turistëve (Tabela 60). Gjithashtu, për vitin 2019 përsëri kryeson Saranda me fluksin më të lartë të turistëve, e ndjekur nga Syri i Kaltër (m=200) dhe Zvërneci (m=188; Tabela 60). Përmeti (m=42), Bënja (m=47) dhe Porto Palermo, ashtu si një vit më parë, janë zonat me mesatare më të ulët të numrit të turistëve, krahasuar me destinacionet e tjera të përfshira në projekt.

Duke krahasuar mesataren e numrit të turistëve gjatë viteve 2019 dhe 2020, rezulton se në Orrik ka një rritje prej 2.8% të numrit mesatar të turistëve dhe në Benje përqindja e turistëve që vizitojnë këtë vend ka rënë, prej 40.2%.

Tabela 60. Numri mesatar i turistëve gjatë shtatë ditëve të javës, 2020

Nr.	Vendndodhja	Dita 1	Dita 2	Dita 3	Dita 4	Dita 5	Dita 6	Dita 7	Mesatarja
1	Sarandë – Shëtitorja	1000+	1000+	1000+	1000+	1000+	1000+	1000+	1000
2	Gjirokastrë – Kalaja	113	142	159	104	112	145	103	125
3	Berat – Kalaja	75	65	71	82	57	98	56	72
4	Përmet – Qendra qytetit	32	27	54	41	62	41	34	42
5	Bënjë – Ujërat Termal	25	36	64	24	65	42	65	46
6	Porto Palermo – Kalaja	85	91	65	75	98	87	68	81
7	Zvërnec – Hyrja e Kishës	120	113	124	140	126	140	113	125
8	Orrik - Qyteti i Lashtë	113	125	125	144	175	185	145	145
9	Syri Kaltër – Burimi	150	167	198	231	205	221	232	201

Burimi: ACER, Studimi 2020 Viti III

**Tabela 61. Numri mesatar i turistëve gjatë shtatë ditëve të javës, 2019**

Nr.	Vendndodhja	Dita 1	Dita 2	Dita 3	Dita 4	Dita 5	Dita 6	Dita 7	Mesatarja
1	Sarandë- Shëtitorja	1000+	1000+	1000+	1000+	1000+	1000+	1000+	1000
2	Gjirokastër – Kalaja	142	186	250	240	165	140	142	181
3	Berat – Kalaja	113	120	115	62	75	158	116	108
4	Përmet – Qendra e qytetit	42	50	78	56	69	55	70	60
5	Bënjë – Ujërat Termal	70	82	110	113	42	56	69	77
6	Porto Palermo – Kalaja	90	86	70	60	112	95	82	85
7	Zvërnec – Hyrja e Kishës	140	152	178	226	223	200	195	188
8	Orik - Qyteti i Lashtë	120	115	185	169	140	145	110	141
9	Syri Kaltër – Burimi	170	165	223	245	250	180	165	200

Burimi: ACER, Studimi 2019 Viti II

**Tabela 62. Numri mesatar i turistëve gjatë shtatë ditëve të javës 2018**

Nr.	Vendndodhja	Dita 1	Dita 2	Dita 3	Dita 4	Dita 5	Dita 6	Dita 7	Mesatarja
1	Sarandë- Shëtitorja	1000+	1000+	1000+	1000+	1000+	1000+	1000+	1000
2	Gjirokastër – Kalaja	175	165	185	230	210	150	145	180
3	Berat – Kalaja	120	110	120	80	90	200	200	131
4	Përmet – Qendra e qytetit	50	45	50	70	80	55	40	56
5	Bënjë – Ujërat Termal	50	65	70	90	80	70	65	70
6	Porto Palermo – Kalaja	80	75	90	65	100	110	80	86
7	Zvërnec – Hyrja e Kishës	120	135	140	220	200	220	180	174
8	Orik - Qyteti i Lashtë	80	100	95	110	135	120	100	106
9	Syri Kaltër – Burimi	140	155	170	220	230	200	180	185

Burimi: ACER, Studimi 2018 Viti I

Duke krahasuar mesataren e numrit të turistëve gjatë viteve 2019 dhe 2020, rezulton se në Orik ka një rritje prej 2.8% të numrit mesatar të turistëve dhe në Bënja përqindja e turistëve që vizitojnë këtë destinacion turistik është ulur, me 40.2%. Tabela 63 tregon përqindjet e rritjes ose uljes së numrit mesatar të turistëve në secilin destinacion turistik, krahasuar me vitin paraprak.

**Tabela 63. Përqindja e uljes së numrit mesatar të turistëve krahasuar vitin 2019 me 2020**

No.	Touristic destination	Year 2019	Year 2020	Percentage of Decrease/ Increase
		Mean	Mean	
1	Sarande-Promenade	1000	1000	0%
2	Gjirokaster – Castle	181	125	-30.9%
3	Berat – Castle	108	72	-33.3%
4	Permet – Town Square	60	42	-30%
5	Bënja – Thermal Water	77	46	-40.2%
6	Porto Palermo – Castle	85	81	-4.7%
7	Zvernec – Church Entrance	188	125	-33.5%
8	Orik – Ancient City	141	145	2.8%
9	Blue Eye – Source	200	201	0.5%

Burimi: ACER, Studimi 2019 Viti II; Studimi 2020 Viti III

## Kapitulli 5. Konkluzione dhe Rekomandime

Konkluzionet e listuara më poshtë janë rezultat i studimit sasior dhe cilësor të kryer në kuadër të vlerësimit të zbatimit të PZHIUT:

- Grupmosha që preferon të udhëtojë në Shqipëri për vitin 2020 është 26-35 vjeç, (28.5%) e ndjekur nga 22.5% e turistëve në intervalin 36-45 vjeç dhe 19% nga 18-25 vjeç. Shpërndarja e moshës është shumë e ngjashme krahasuar me vrojtimin e vitit 2019, 2018 dhe studimin bazë.
- Turistët ndërkombëtarë (63%) zënë peshën më të madhe të numrit të turistëve në vend, që hyjnë në Shqipëri kryesisht nëpërmjet *aeropotit* (60%) dhe rrugëve tokësore (27.5%). Turistët përgjithësisht janë vizitorë të rinj (72%), që nuk kanë qenë më parë në Shqipëri. Ndërkohë, krahasuar me një vit më parë, është rritur numri i turistëve që e vizitojnë më shumë se një herë Shqipërinë (nga 22% në 28%).
- Mesatarja kombëtare e ditëve të qëndrimit të turistëve në Shqipëri përlllogaritet 8 ditë, edhe pse kemi një *ulje të numrit të turistëve që qëndrojnë mesatarisht 8 ditë në një zonë* (nga 57.7 % në 56.4 %). Ky rezultat mund t'i atribuohet situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19.
- Krahasuar me një vit më parë, në vitin 2020 kemi një rritje të numrit të turistëve që vizitojnë Shqipërinë nëpërmjet *paketave turistike* (nga 9.4% në 12.2%). Kjo rritje tregon përmirësim të cilësisë dhe vlerës së paketave turistike, pavarësisht gjendjes së krijuar nga pandemia globale.
- Krahasuar me studimin e vitit 2019 dhe 2018, *niveli mesatar i kënaqësisë së përgjithshme, ka pësuar rritje të lehtë*, nga 4.07 në vitin 2018, 4.05 në vitin 2019 në 4.08 në vitin 2020. Nivelin më të lartë të kënaqësisë e ka Saranda (4.49), e pasuar nga Përmeti (4.37) dhe Gjirokastra (4.29).
- Në përgjithësi, *kënaqësia e turistëve në lidhje me aktivitetet është rritur për çdo destinacion turistik*. Krahasuar me një vit më parë, *kënaqësia e turistëve në lidhje me plazhet* (pohuar nga turistët e pyetur në Sarandë, Berat, Përmet, Syri i Kaltër, Porto palermo dhe Bënja), *performanca muzikore* (pohuar nga turistët e pyetur në Sarandë, Gjirokastrë, Përmet, Syri i Kaltër dhe Bënja), *marshimi* (pohuar nga turistët e pyetur në Berat dhe Përmet) dhe *gastronomia vendase* (pohuar nga turistët e pyetur në Berat, Përmet dhe Syri i kaltër) është ulur ndjeshëm.
- Për vitin 2020, pakënaqësitë e turistëve, rezultojnë të jenë: *mungesa e një infrastrukture të përshtatshme që lidh qendrën e qytetit me fshatrat apo zona të caktuara turistike, transaksionet e pagesave me kartë debitil/ krediti, transporti publik vendor, zonat rekreative për fëmijë dhe pastrimi*. Këto të dhëna kanë rezultuar nga vrojtimi i turistëve në 16-31 Gusht, ndërkohë konfirmohen edhe nga diskutimet online në grupet e fokusuara.
- Lehtësia e gjetjes së informacionit është rritur lehtë krahasimisht me një vit më parë dhe me studimin bazë, si rrjedhojë e rritjes së shumëllojshmërisë së burimeve të informacionit (3.15 në vitin 2016, 3.21 në vitin 2019 dhe 3.25 në vitin 2020).
- Të pohuara njëkohësisht edhe nga grupet e fokusuara, turistët kanë shprehur pakënaqësi në lidhje me parkimin, nivelin e papastërtisë, mungesën e zonave argëtuese për fëmijë, dhe transportin publik vendor. Në lidhje me vlerësimin e shpenzimeve mesatare ditore të turistëve gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri, rezultoi se mesatarisht një turist shpenzon 46.68 Euro në ditë, 0.63 Euro më pak krahasuar me vitin e kaluar.



Duke konsideruar të dhënat e gjeneruara nga studimi sasior dhe konsultimin me pjesëmarrës përgjatë grupeve të fokusuara si dhe situatën e pandemisë në vend, më poshtë listohen disa rekomandime, që kanë si qëllim final rritjen e numrit të frekuentimeve nga turistët në zonat e studiuara:

- **Mbështetje efektive e komunitetit të biznesit:** Të dhënat e gjeneruara nga studimi sasior dhe cilësor, tregojnë nevojën emergjente të bizneseve për mbështetje në forma të ndryshme (qoftë nga qeverisja qendrore, qoftë ajo vendore). Sfidat e krijuara nga pandemia, kanë reduktuar aftësinë financiare të bizneseve vendore, duke rrezikuar në këtë mënyrë mbylljen e tyre. Efekti zinxhir negativ në ekonominë vendore ashtu edhe atë kombëtare, është i madh. Për këtë, sugjerohet ndërtimi i instrumentave dhe paketave financiare, për t'i ardhur në ndihmë komunitetit lokal të bizneseve.
- **Vazhdimi i përmirësimit të infrastrukturës:** Studimi sasior dhe cilësor konfirmojnë përmirësimet që destinacionet turistike kanë bërë në lidhje me infrastrukturën. Megjithatë, ajo vazhdon të mbetet shqetësim në disa nga zonat e studiuara. Për këtë, pushteti vendor dhe qendror do të duhet që intensifikojë përpjekjet për përmbylljen e projekteve infrastrukturore emergjente, në një kohë sa më të shpejtë.
- Për zbutjen e efekteve negative të krizës së Covid-19, sugjerohet përmirësimi i **bashkëpunimit midis qeverisë sektorit privat dhe shoqërisë civile** me synim rritjen e sigurisë shëndetësore veçanërisht objektet e akomodimit dhe restorantet si dhe promovimin e turizmit të brendshëm, por edhe nxitjen e kërkesës nga vendet e rajonit duke filluar me Kosoven përmes sigurimit të stimujve të ndryshëm për qytetarët që të kalojnë pushimet e tyre në Shqipëri. Këtij qëllimi mund t'i shërbejë edhe intensifikimi i dialogut qeveri-komunitet i biznesit për vendim-marrje të mirë menduara për mbështetjen shtetërore ndaj turizmit, etj. Në këtë mënyrë sektori i turizmit do të nxitet që të adaptojë ofertën e vet në tregun e ri rajonal dhe global të turizmit, sapo të hiqen kufizimet për shkak të pandemisë.
- Për rikuperimin e ndikimit të pandemisë në ekonominë shqiptare, sugjerohet që **kjo ekonomi të diversifikojë ofertën e vet dhe të orientojë zhvillimin e mëtejshëm të turizmit në destinacione të reja duke theksuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.** Vendi ka potencial të lartë (trashëgimi natyrore dhe kulturore) për zhvillimin e turizmit, nga turizmi masiv me destinacione të mbipopulluara në pjesën Perëndimore të saj, në destinacione të gjelbërta dhe të qëndrueshme, duke ofruar përvoja unike të turizmit në Shqipërinë Lindore.
- **Promovim efektiv i vlerave turistike duke ndjekur një qasje holistike:** Pavarësisht trendit rritës të vizitorëve/turistëve, përsëri studimet identifikojnë nevojën e një promovimi më efektiv të destinacioneve turistike në Shqipëri. Për këtë, është e nevojshme ndërtimi i një qasje gjithpërfshirëse midis aktorëve kryesorë të sektorit të turizmit.



# Aneks I: Pyetësi i Vrojtimit të Turistëve

<b>ID. Numri Serial</b>				d	d	m	m
<b>Data e intervistës</b>							2 0 1 9
				h	h	m	m
<b>Koha e fillimit</b>							
<b>Koha e mbarimit</b>							
<b>Kohëzgjatja e intervistës</b>							
<b>Shkruaj numrin e refuzimeve që kanë ndodhur. Në qoftë se asnjë, shëno 0.</b>							
<b>Emri i të intervistuarit</b>							
<b>Zona: Pika turistike</b>				<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Saranda – Shëtitorja</li> <li>2. Gjirokastrë – Kalaja</li> <li>3. Berat – Kalaja</li> <li>4. Permet – Qendra e Qytetit</li> <li>5. Syri i Kaltër – Burimi</li> <li>6. Porto Palermo – Kalaja</li> <li>7. Bënja – Ujërat Termale</li> <li>8. Porto Palermo – Kalaja</li> <li>9. Zvërnec – Hyrja e Kalasë</li> </ol>			
<b>GJUHA: Gjuha e pyetësit</b>				<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqip</li> <li>2. Anglisht</li> <li>3. Italisht</li> </ol>			

## HYRJE

*Ky studim është bërë përmes intervistave ballë për ballë. Gjatë intervistës, ju lutemi lexoni pyetjet ashtu siç janë formuluar në pyetësor. Rrethoni kodet përkatëse për secilën përgjigje. Pyetjet e hapura duhet të shkruhen pikërisht siç janë dhënë nga i intervistuari. Udhëzimet për intervistuesit janë në shkronja italike*

### Për t'u lexuar nga intervistuesi:

Përshëndetje. Unë jam \_\_\_\_\_ dhe punoj për QSHKE. Kompania QSHKE po kryen një vërtetim mbi perceptimet dhe përvojat e vizitorëve lidhur me vizitën aktuale në zonën turistike. Ju jeni zgjedhur në mënyrë të rastësishme si pjesë e këtij studimi. Përgjigjet tuaja janë konfidenciale dhe askush nuk do ta njohë emrin tuaj ose nuk do të lidhë emrin tuaj me përgjigjet. A keni ndonjë pyetje? Mund të fillojmë? Faleminderit!

### A. PROFILI I RESPONDENTIT

<b>A1</b>	<b>Gjinia</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mashkull</li> <li>2. Femër</li> </ol>
<b>A2</b>	<b>Mosha</b>	_____ vjeç.

<b>A3</b>	<b>A jeni?</b>	1. Një shqiptar që jeton në Shqipëri 2. Një shqiptar që jeton jashtë vendit 3. Një i huaj që banon në Shqipëri 4. Një i huaj që viziton Shqipërinë
<b>A4</b>	Nëse A3 = 2 ose 4 Pyetni <b>Në cilën vend banoni?</b>	_____
<b>A4.1</b>	Nëse A3 = 2 ose 4 <b>A mund të na tregoni pikën tuaj të hyrjes në Shqipëri?</b>	1. Airport 2. Portin e Durrësit 3. Portin e Vlorës 4. Porti i Sarandës 5. Hyrja e kufirit tokësor, specifikoni _____
<b>A5</b>	Nëse kërkohet A3 = 4 <b>A është kjo hera e parë që vizitoni Shqipërinë?</b>	1. Po 2. Jo
<b>A6</b>	Pyesni të gjithë <b>Ju lutem, më tregoni sa ditë (nga dita kur keni hyrë në ditën që do të largoheni) do të jetë qëndrimi juaj në Shqipëri.</b>	_____ ditë.
<b>A7</b>	Pyesni të gjithë <b>Është hera e parë që vizitoni _____?</b>	1. Po 2. Jo
<b>A8</b>	<b>A mund të pyes për statusin tuaj të punësimit? A jeni?</b>	1. Një student 2. Pensionisti 3. Punonjës me orar të plotë 4. Një punonjës me kohë të pjesshme 5. Të vetëpunësuar 6. Aktualisht i papunë 7. Të tjera, specifikoni
<b>A9</b>	<b>Cila është niveli më i lartë i arsimimit që keni kryer?</b>	1. Fillore 2. Shkolle e Mesme 3. Profesionale 4. Universitet 5. Pas-Universitar
<b>A10</b>	<b>Sa i përket vizitës që keni me _____, a jeni?</b>	1. Turist i pavarur 2. Pjesë e paketës turistike 3. Tjetër, specifiko _____
<b>A11</b>	<b>A po e vizitoni vendin vetë apo me dikë?</b>	1. Vetëm 2. Me grup/familje
<b>A12</b>	Nëse A10=2, Pyet <b>Sa persona janë në grupin tuaj?</b>	_____ persona.
<b>A13</b>	Nëse ZONA=1, 2, 3 ose 4, atëherë pyet <b>Ju lutem më thoni sa ditë do të qëndroni në këtë pikë turistike</b>	<b>A13.1</b> ...deri tani _____ <b>A13.2</b> ...për t'u harxhuar brenda ditës _____
<b>A14</b>	Nëse ZONA =5, 6 ose 7, pyet <b>Ju lutem më thoni sa ore do të qëndroni në këtë pikë turistike</b>	<b>A14.1</b> ... deri tani _____ <b>A14.2</b> ... për t'u harxhuar brenda ditës _____

## B. INFORMACION TREGU

<b>BI</b>	<b>Ku e morët informacionin për...</b>  <i>Zgjidh të gjitha të mundshmet (Disa)</i>	<b>BI.1 Shqipëria</b> A. Radio B. TV C. Gazete D. Reviste E. Internet F. Broshure udhëtimi  G. Operator turistik H. Nga miqtë/të afërmit I. Tjetër	<b>BI.2 Zonën turistike</b> A. Radio B. TV C. Gazete D. Reviste E. Internet F. Broshure udhëtimi  G. Operator turistik H. Nga miqtë/të afërmit I. Tjetër	
<b>B2.</b>	<b>Cfarë aktivitete turistike keni bërë ose keni në plan të bëni në Shqipëri e Jugut?</b>			
	<b>Aktiviteti</b>	<b>B2.1 Eshtë bërë</b>	<i>(Nëse B2.1=2)</i> <b>B2.2 Do të bëhet</b>	<i>(IF HI=1)</i> <b>B2.3 Vlerëso në një shkallë 1-5 cilësinë e eksperiencës tuaj ku 1=Shumë keq dhe 5=Shumë mirë</b>
	<b>A.</b> Vizita e kishave, muzeve ose monumenteve kulturore (Kala, Rrenja, pika arkeologjike etj)	1. Po 2. Jo	1. Po 2. Jo	1 2 3 4 5
	<b>B.</b> Plazhi	1. Po 2. Jo	1. Po 2. Jo	1 2 3 4 5
	<b>C.</b> Vizita e muzeumeve	1. Po 2. Jo	1. Po 2. Jo	1 2 3 4 5
	<b>D.</b> Pjesëmarrja në performancë muzikore ose artistike (këndim, punë me dorë etj)	1. Po 2. Jo	1. Po 2. Jo	1 2 3 4 5
	<b>E.</b> Pjesëmarrja në ceremoni fetare	1. Po 2. Jo	1. Po 2. Jo	1 2 3 4 5
	<b>F.</b> Pjesëmarrja në festival	1. Po 2. Jo	1. Po 2. Jo	1 2 3 4 5
	<b>G.</b> Vizita e fshatrave/komuniteteve përreth	1. Po 2. Jo	1. Po 2. Jo	1 2 3 4 5
	<b>H.</b> Vizita e parqeve natyrore	1. Po 2. Jo	1. Po 2. Jo	1 2 3 4 5
	<b>I.</b> Marshim/ Ciklizëm	1. Po 2. Jo	1. Po 2. Jo	1 2 3 4 5
	<b>J.</b> Aventura turistike si rafting, hedhje me parashutë, sporte ujore ...	1. Po 2. Jo	1. Po 2. Jo	1 2 3 4 5
	<b>K.</b> Pazar për suvenire	1. Po 2. Jo	1. Po 2. Jo	1 2 3 4 5
	<b>L.</b> Kuzhina vendase	1. Po 2. Jo	1. Po 2. Jo	1 2 3 4 5
	<b>M.</b> Bar – kafe, klube nate	1. Po 2. Jo	1. Po 2. Jo	1 2 3 4 5
	<b>N.</b> Sporte ujore	1. Po 2. Jo	1. Po 2. Jo	1 2 3 4 5

**B3** Cilat destinacione keni vizituar në Shqipëri dhe si e vlerësoni cilësinë e eksperiencës ( deri në 3)?  
Emrat e destinacionave si qytete, fshatra, bashki etj.

Vlerëso cilësinë e eksperiencës në një shkallë 1 në 5 ku 1=Shumë keq dhe 5=Shumë mirë

<b>A.</b> _____	1	2	3	4	5
<b>B.</b> _____	1	2	3	4	5
<b>C.</b> _____	1	2	3	4	5
<b>D.</b> Tjetër: _____	1	2	3	4	5

**B4** Pyet të gjitha

**Si do ti vlerësonit aspektet e mëposhtme të qëndrimit tuaj duke marrë në konsideratë të gjithë Shqipërinë jugore?**

(Rretho një numër përgjigjesh të cilat përfaqësojnë vlerësimin tuaj për cdo aspekt)

Produkte, Shërbime dhe Mikëpritja	Shumë mirë	Mirë	Keq	Shumë Keq
<b>A.</b> Shërbimet doganore në pikën e hyrjes	4	3	2	1
<b>B.</b> Përshatshmëria e pikës së hyrjes	4	3	2	1
<b>C.</b> Siguria personale	4	3	2	1
<b>D.</b> Miqësia e njerëzve	4	3	2	1
<b>E.</b> Kuzhinë/pijet vendase	4	3	2	1
<b>F.</b> Cilësia e restoranteve	4	3	2	1
<b>G.</b> Cilësia e qëndrimit	4	3	2	1
<b>H.</b> Cilësia e shërbimit (në restorante, hotele etj.)	4	3	2	1
<b>I.</b> Aksesit në pikat e trashëgimisë kulturore	4	3	2	1
<b>J.</b> Përkthimi në pikat e trashëgimisë kulturore	4	3	2	1
<b>K.</b> Sinjalistika në pikat e trashëgimisë kulturore	4	3	2	1
<b>L.</b> Informacioni mbi trashëgimitë historike	4	3	2	1
<b>M.</b> Cilësia e guidave	4	3	2	1
<b>N.</b> Shkalla e njohjes së gjuhës së huaj	4	3	2	1
<b>O.</b> Shërbimet policore	4	3	2	1
<b>P.</b> Fasilitetet për fëmijë	4	3	2	1
<b>Q.</b> Mundësi për Pazar	4	3	2	1
<b>R.</b> Telekomunikacioni (telefon, internet...)	4	3	2	1
<b>S.</b> Aksesit në transport public	4	3	2	1
<b>T.</b> Fasilitetet për këmbimet valutore	4	3	2	1
<b>U.</b> Transaksionet me kartë (debiti/kredit)	4	3	2	1

<b>B5</b>	<b>Në përgjithësi gjatë gjithë qëndrimit tuaj në Shqipërinë Jugore, duke marrë në konsideratë të gjithë aspektet e mësipërme, si e vlerësoni qëndrimin tuaj?</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shumë i pakënaqur</li> <li>2. I pakënaqur</li> <li>3. Neutral</li> <li>4. I kënaqur</li> <li>5. Shumë i kënaqur</li> </ol>
-----------	--	--

**B6** (Nëse ZONA=5, 6 ose 7 atehere pyet)

**Si i vlerësoni aspektet e mëposhtme?**

<b>Produktet, Shërbimet dhe Mikëpritja</b>	<b>Shumë mirë</b>	<b>Mirë</b>	<b>Keq</b>	<b>Shumë keq</b>
<b>A.</b> Lehtësia për të gjetur informacion për zonën përpara ardhjes	4	3	2	1
<b>B.</b> Lehtësia për të gjetur vendodhjen e zonës	4	3	2	1
<b>C.</b> Atraktiviteti natyror i zonës	4	3	2	1
<b>D.</b> Cilësia e fasiliteve të parkimit	4	3	2	1
<b>E.</b> Cilësia e shtigjeve të ecjes	4	3	2	1
<b>F.</b> Cilësia e restoranteve	4	3	2	1
<b>G.</b> Cilësia e fasiliteve rekreative	4	3	2	1
<b>H.</b> Niveli i pastërtisë në zone	4	3	2	1
<b>I.</b> Cilësia dhe ekzistenca e tualeteve në zonë	4	3	2	1
<b>J.</b> Prania e sinjalistikës	4	3	2	1
<b>K.</b> Cilësia e guidave	4	3	2	1
<b>L.</b> Fasilitetet për fëmijë	4	3	2	1

### C. INFORMACION MBI SHPENZIMET

<b>C1</b>	<b>A keni ardhur si pjesë e një pakete turistike?</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Po</li> <li>2. Jo</li> </ol>
<b>C2</b>	<b>Duke konsideruar qëndrimin tuaj në këtë destinacion/zonë, a mund të më thoni mesterisht sa para skeni shpenzuar për frymë në bazë ditore? (duke numëruar të gjitha shpenzimet, ture turistike, akomodim, ushqim, transport, aktivitete, shopping)</b>	<b>C2E.</b> _____ EURO <b>C2L.</b> _____ Lek <b>C2C.</b> Koment _____

**Faleminderit!**

## Aneks 2: Materiale Informuese mbi DGF

### Informacion mbi Projektin për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turizmin

Kohëzgjatja: 2017 – 2022

Financues: Banka Botërore

Zbatuar nga: Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Shtrirja gjeografike: 3 qarqe (Vlorë, Berat, Gjirokastrë); 4 bashki (Sarandë, Gjirokastrë, Berat, Përmet) dhe korridori turistik që kalon në këtë rajon.

Përfitues: 84 mijë banorë dhe rreth 300 mijë turistë.

Objektivi i projektit është përmirësimi i infrastrukturës urbane, nxitja e turizmit dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për të mbështetur turizmin dhe zhvillimin e ekonomisë vendore në zonat e përzgjedhura në jug të Shqipërisë. Projekti do të ndikojë në zhvillimin e ekonomisë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në rajonin e jugor të vendit, nëpërmjet financimit të projekteve të infrastrukturës.

#### Komponentët e Projektit:

- Projektimi urban dhe përmirësimi i infrastrukturës
- Përmirësimi i zonave turistike
- Tregu i turizmit dhe zhvillimi i produkteve

Në kuadër të këtij projekti, financuar nga Banka Botërore dhe zbatuar përmes Fondit Shqiptar të Zhvillimit, QSHKE është kontraktuar për të ofruar shërbime konsulente. Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QSHKE) ka ndërmarrë zhvillimin e një studimi që ka për qëllim vlerësimin e implementimit të projektit dhe arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Projektit deri në Gusht 2019, krahasuar me studimin bazë të realizuar në 2016 dhe studimin e realizuar në vitin 2018. Ky studim synon të identifikojë arritjet e bëra nga viti 2016 dhe 2018, të vlerësojë statusin aktual të projektit në përputhje me Objektivat e Zhvillimit, si dhe të propozojë rekomandime për vazhdimësinë e zhvillimit të projektit, me një fokus të veçantë në përdorimin e shërbimeve publike dhe infrastrukturës nga turistët, nivelit të kënaqësisë së turistëve me këto shërbime, si dhe trendit të përgjithshëm të shpenzimeve gjatë vizitës së tyre në vend.

Në kuadër të këtij studimi, do të zhvillohen 4 diskutime në grup të fokusuar në katër qytete: Berat, Përmet, Gjirokastrë dhe Sarandë me qëllim ndarjen e gjetjeve kryesore që kanë dalë nga studimi sasior, si dhe marrjen e të dhënave më të thelluara nga aktorë të përfshirë në zbatimin e projektit.

## AGJENDA

### DISKUTIME NË GRUP TË FOKUSUAR Projekti për Zhvillim e Integruar Urban dhe Turizmin Vrojtimi i Turistëve, Gusht-2020

**Qyteti :**

**Data:**

**Ora:**

**Vendi i takimit:**

---

#### Pjesëmarrës:

- Përfaqësues nga Bashkia
- Përfaqësues nga Biznese/Shoqata
- Përfaqësues nga Familjet
- Stafi Realizues i Studimit nga ACER

Ora:\_\_\_\_:\_\_\_\_

Përshkrimi i Projektit

Qëllimi i takimit

Prezantimi i Pjesëmarrësve

Ora:\_\_\_\_:\_\_\_\_

Diskutime nga të pranishmit rreth gjetjeve të Vrojtimin të Turistëve (2020)

---

Për më shumë informacion kontaktoni:

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike

Bylyre Serjanaj (Kerkuese shkencore)

[researchassistant.bs@gmail.com](mailto:researchassistant.bs@gmail.com)

Tel: 0689011619

## PROJEKTI PËR ZHVILLIM TË INTEGRUAR URBAN DHE TURIZËM

### Diskutime në Grup të Fokusuar

#### LISTA E PYETJEVE TË NDARË SIPAS GRUPEVE TË INTERESIT

##### **PËR FAMILJET**

1. Si e vlerësoni cilësinë e aspekteve të mëposhtme të hapësirave publike në qytetin tuaj? A ka patur përmirësime krahasuar me vitin e kaluar?

a. Rrugët e lagjes:

b. Rrugët kryesore;

c. Trotuaret;

d. Parqet dhe zonat e gjelbra;

e. Shëtitorët;

f. Ndriçimi i rrugëve;

2. Si i vlerësoni cilësinë e aspekteve të mëposhtme? A ka patur përmirësime krahasuar me vitin e kaluar?

a. Ruajtja e vendeve dhe strukturave historike;

b. Kushtet dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe strukturave të parkut dhe sheshit të lojërave;

c. Siguria e parqeve dhe zonave të frekuentuara nga turistët;

d. Pastërtia dhe mirëmbajtja e parqeve;

3. Sipas opinionit tuaj, a ka patur një rritje/përmirësim të aktiviteteve turistike në qytetin tuaj krahasuar me dy vite më parë? Konkretisht çfarë?

4. A keni patur juve/familja juaj ndonjë përfitim direkt/indirekt nga përmirësimi/rritja e numrit të turistëve në zonë?

- Përfitime direkte: LISTO

- Përfitime indirekte: LISTO

5. A jeni juve apo të njohurit tuaj duke ushtruar ndonjë aktivitet ekonomik në shtëpinë tuaj? (shtëpi pritëse, produkte për shitje, etj).

6. Çfarë mendoni që duhet përmirësuar në zonën tuaj/ndërhyrjesh duhen bërë, në mënyrë që të kemi një rritje të numrit të turistëve, shtimit të netëve të qëndrimit të turistit, në mënyrë që edhe ju vetë të keni përfitime?



## **PËR BIZNESIN**

1. Cili është profili i biznesit tuaj? Çfarë aktivitete kryeni aktualisht?
2. A e keni pasuruar listën e produkteve/shërbimeve të biznesit tuaj gjatë dy viteve të fundit? Konkretisht çfarë?
3. Cilat janë problemet me të cilat po përballë biznesi juaj aktualisht? (taksat, kontrolli tatimor, mungesa e financimit, korrupsioni, informaliteti, mungesa e punonjësve të kualifikuar- këto do merren një për një në varësi të përgjigjes së biznesit). Si mund të zgjidhen këto probleme?
4. Një nga rezultatet e studimit është pakënaqësia ndaj shërbimit të ofruar. Cilat janë përpjekjet tuaja për përmirësimin e këtij të fundit.
5. Gjatë vitit të fundit (2019), ç'pjesë e turistëve kanë qenë të huaj dhe shqiptar? Si e shikoni trendin e turistëve këtë vit, krahasuar me një vit më parë, në biznesin tuaj?
6. Sa shpenzonte mesatarisht një turist huaj/shqiptar në terma ditorë, në 2018? Si ka ndryshuar kjo në 2019? Në terma financiare, si e vlerësoni performancën e biznesit tuaj këtë vit krahasuar me një vit më parë?
7. Sa qëndronte mesatarisht një turist vitin e kaluar? Po këtë vit? Pse është një qëndrim kaq i shkurtër? Cilët janë faktorët që pengojnë/duhet të nxisin zgjatjen e qëndrimit të një turisti në zonën tuaj?
8. A keni dëgjuar për zyrat e menaxhimit të destinacionit (lidhin pushtetin vendor me biznesin)?
9. Si lidheni ju me turistin? Çfarë aktivitete promovuese realizoni/po instrumentet? (A jeni në Airbnb, etj)?
10. Çfarë aktivitete të tjera duhet të shtohen nga biznesi juaj që të pasurohet një paketë turistike? Cilat faktorë pengojnë në arritjen e kësaj?
11. A jeni në dijeni të granteve të jep AZHBR (bëhet fjalë për bujtinat)? A keni aplikuar?
12. Sipas mendimit tuaj, çfarë masash duhet të ndërmerren nga pushteti vendor dhe pushteti qendror në mënyrë zhvillimit të turizmit në vend dhe fuqizimit të komunitetit në zonat e ndërhyra?

## **PËR NJËSITË E PUSHTETIT VENDOR**

1. Si ka qenë frekuenca e turistëve gjatë tre viteve të fundit? A keni juve një regjistër statistikor që gjurmon numrin e turistëve, statusin e tyre dhe netët e qëndrimit?
2. Çfarë investimesh janë bërë në kuadër të Projekti për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turizëm?
3. A ka patur përmirësime në ofrimin e shërbimeve publike në zonën tuaj (mbledhja e mbetjeve, infrastruktura, etj.)
4. A keni ndërtuar juve një bazë të dhënash me aktorët kyç me të cilët duhet të bashkëpunoni për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit, në disa drejtime? (DMO, etj.)
5. Sipas opinionit tuaj, a po shfrytëzohen siç duhet asetet e zonës tuaj, në kuadër të zhvillimit të turizmit?
6. Cilat janë ndërhyrjet më emergjente që projekti duhet të realizojë me qëllim rivitalizimin e zonës, shfrytëzimin më të mirë të aseteve, pasurimin e paketës së turistit me qëllim zgjatjen e qëndrimit të tij dhe rritjes së kënaqësisë?

## Aneks 3: Gjetjet e Grupeve te Fokusuara

### 3/I Diskutime në Grup të Fokusuar - Berat

#### Hyrje

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QSHKE) si pjesë e zhvillimit të studimit për vlerësimin e zbatimit të Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmit zhvilloi diskutimin në grup të fokusuar në Berat, zonë ku janë duke u bërë disa ndërhyrje nga ky projekt. Ky takim u organizua me qëllim ndarjen e gjetjeve paraprake nga studimi sasior i kryer nga QSHKE në muajin Gusht të këtij viti, ndërthurjen e këtyre gjetjeve me disa të dhëna cilësore, si dhe marrjen e të dhënave më të thelluara nga aktorë të përfshirë në zbatimin e projektit në këtë qytet, kryesisht në përputhje me 3 komponentët e projektit: Projektimin urban dhe përmirësimin e infrastrukturës, përmirësimin e zonave turistike, si dhe tregun e turizmit dhe zhvillimi e produkteve.

#### Metodologjia

Në datën 02/10/2020 u zhvillua diskutimi në grup të fokusuar në platformën online “Zoom Meeting” me pjesëmarrës nga Qyteti i Beratit. Diskutimi nisi në orën 09:00 dhe përfundoi në orën 10:20. Zhvillimi i takimit u drejtua nga M.Sc Bylyre Serjanaj dhe asistuar nga M.Sc Amena Losha duke nisur me prezantim të shkurtër të gjetjeve paraprake të vrojtimit në përgjithësi dhe posaçërisht për qytetin e Beratit. Më pas takimi vijoi nëpërmjet bashkëbisedimit me pjesëmarrësit me pyetje-përgjigje bazuar në një listë pyetjesh orientuese të ndara në 3 kategori: pyetje për familjarët, për bizneset dhe për pushtetin vendor.

Në takim morën pjesë 16 persona që ishin përfaqësues nga Bashkia (Drejtoresha e turizmit dhe specialistë të tjerë), nga biznese vendore dhe familjarë. Bazuar në pyetjet orientuese, por edhe në përvojën e secilit nga pjesëmarrësit me turistët, gjatë diskutimeve u vunë në dukje njohuritë që ata kishin lidhur me projektin PZHIUT që po zhvillohet duke paraqitur anët pozitive të projektit por edhe problematika dhe rekomandime për zgjidhje/ përmirësime të mundshme. Të ftuarve ju është dërguar paraprakisht me e-mail seti i materialeve si: Agjenda e takimit, Të dhëna mbi projektin, dhe Pyetjet e Orientuese të diskutimit. Në fund të këtij dokumenti gjendet listë prezenca e të ftuarve dhe foto të ekranit nga Zoom ([Aneks 4](#)).

#### Identifikimi i Çështjeve Kryesore

##### Gjetje kryesore

- Në qytetin e Beratit kanë ndodhur ndryshime këtë vit, si rikonstruktimi i rrugëve kryesore, ka filluar rikonstruktimi i “Rr Muzak Topia dhe “Mihal Kakomeno”, por ende pa përfunduar si vijat e bardha dhe ndriçimi.
- Mungesa e një parkimi në qendër të qytetit është një problem për turistët
- Ndriçimi i qytetit jo në nivelin e duhur
- Berati konsiderohet si një qytet relativisht i pastër për sa i përket nivelit të pastërtisë. Problemi nuk qëndron te turistët por tek vendasit. Përkundrazi problemi që hasin turistët janë prania e lartë e genve të rrugës që duhen mbajtur nën kontroll.
- Mungon njehsimi i të dhënave mbi numrin e turistëve që mblidhen nga 3 burime: shitja e biletave te kalaja (zyrtarja që përdoret); zyra e informacionit në bashki dhe muzeu Onufri.
- Lloji i turistit ka qenë turist i pavarur dhe eksplorues, vendas. Ndërsa turistët e huaj kanë qenë në një numër jashtëzakonisht të vogël dhe ndryshe nga vitet e tjera kanë ardhur nga Evropa Lindore si nga Bjellorusia apo Ukraina.

- Vlerësimi në rritje i kënaqësisë për fshatrat ishte rezultat i pritshëm këtë vit për shkak të ndërhyrjeve në infrastrukturë (Aprovoi gjetjet e vrojtimit 2020).
- Tre fusha me nevojë të menjëhershme ndërhyrje rezultojnë: rikonstruktime në zona jo vetëm rreth Kalasë; rikonceptime të fasadave dhe ndriçimi; kabllot e internetit dhe telefonit të varura duhet të kalojnë nëntokë për t'u paraqitur mirë estetikisht.

## Familjet

Familjarët që morën pjesë në diskutimet në grup të fokusuar kishin relativisht pikëpamje pozitive mbi zbatimin e projektit në qytetin e Beratit.

- Ata pohuan se kishte patur rikonstrukcione të disa rrugëve që janë kërkuar për një kohë të gjatë që të rehabilitohen, por punimet ende janë në proces.
- Mbledhja e mbetjeve bëhet rregullisht.
- Duhet të rritet numri i aktiviteteve të ofruara, por viti 2020 e bëri të pamundur realizimin e kësaj pike
- Parkimi nuk është problem vetëm për turistët por dhe për familjarët.

## Bizneset/ OJF

Profili i bizneseve që morën pjesë këtë vit në diskutimin në grup të fokusuar në Berat i përkiste fushës së hotelerisë, guiderë, agjenci turistike, por dhe OJF që punonin në fushën e turizmit. Hapat kryesorë që duhen ndërmarrë për përmirësimin e ofrimi të shërbimit dhe rritjes së kënaqësisë së turistëve ishin:

- Promovimi sa më serioz i qytetit, kryesisht nga individë me impakt social (influencers)
- Trajnimi i stafit të shërbimit dhe përmirësimi i kushteve të punës në mënyrë që të ofrojë shërbimin e tij në Berat e të mos largohet në Jug të Shqipërisë gjatë sezonit veror.
- Zhvillimi i turizmit eksplorues si një pikë e fortë e Qytetit të Beratit (duke qenë se i mungojnë plazhet). Të rritet përqëndrimi tek aktivitetet eksploruese fetare apo aventuriere që një turist l-ditor të rikthehet sërish dhe vitin tjetër.

Aksesi në përdorimin e transportit publik ka qenë e vështirë për t'u vlerësuar këtë vit për shkak të mbylljes një periudhë dhe hapjes më pas në kushte specifike ndryshe nga vitet e mëparshme. Duke qenë se bizneseve nuk ju janë plotësuar pikat e kërkuar që një vit më parë, në këtë mënyrë ata kërkojnë sërish

- Mbështetje nga pushteti vendor dhe qendror me qëllim zhvillimin e turizmit dhe fuqizimin e komunitetit.
- Trajnimet të stafit me anë të kurseve profesionale
- Pasurimi i paketave turistike me ture/aktivitete të reja; pasurimi i tabelave me udhëzime dhe sinjalistika nëpër qytet për gjetjen e atraksioneve turistike (në disa gjuhë)

## Pushteti Vendor

Bashkia e Beratit ka planifikuar një sërë aktivitete duke filluar që nga Janar 2020, por në vijimësi u ndërpreu për shkak të karantinimit dhe pandemisë. Projekti ka ndikuar shumë pozitivisht në krijimin e infrastrukturës rrugore që lidh qytetin me fshatrat turistike dhe ky është një ndryshim pozitiv për këtë vit. Investime të shumta janë vënë re në restorante dhe bare nga aktorë privat të përfshirë në turizmin e vendit. Ndryshimet pozitive janë të dukshme për vitin 2020 dhe ka ende punë nga grupi i pushtetit vendor të përfshirë në zhvillimin e turizmit të bashkisë së Beratit. Në fokus të veçantë në promovimin e turizmit vendas. Specialistët e turizmit theksojnë se projekti.

- Hartimi i një faqe ëeb promovuese të bashkisë së Beratit me të gjitha destinacionet turistike
- Përfundimi i i infrastrukturës rrugore që lidh qytetin me fshatrat përreth.
- Parkimi dhe pastrimi i qytetit do marrin një vëmendje të veçantë në periudhat e ardhshme.

## 3/2 Diskutime në Grup të Fokusuar - Përmet

### Hyrje

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QSHKE) si pjesë e zhvillimit të studimit për vlerësimin e zbatimit të Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmit zhvilloi diskutimin në grup të fokusuar në Përmet, zonë ku janë duke u bërë disa ndërhyrje nga ky projekt. Ky takim u organizua me qëllim ndarjen e gjetjeve paraprake nga studimi sasior i kryer nga QSHKE në muajin Gusht të këtij viti, ndërthurjen e këtyre gjetjeve me disa të dhëna cilësore, si dhe marrjen e të dhënave më të thelluara nga aktorë të përfshirë në zbatimin e projektit në këtë qytet, kryesisht në përputhje me 3 komponentët e projektit: Projektimin urban dhe përmirësimin e infrastrukturës, përmirësimin e zonave turistike, si dhe tregun e turizmit dhe zhvillimi e produkteve.

### Metodologjia

Në datën 30/09/2020 u zhvillua diskutimi në grup të fokusuar në platformën online “Zoom Meeting” me pjesëmarrës nga Bashkia e Përmetit. Diskutimi nisi në orën 09:30 dhe përfundoi në orën 11:00. Zhvillimi i takimit u drejtua nga M.Sc Bylyre Serjanaj dhe asistuar nga M.Sc Amena Losha duke nisur me prezantim të shkurtër të gjetjeve paraprake të vrojtimit në përgjithësi dhe posaçërisht për bashkinë e Përmetit. Më pas takimi vijoi nëpërmjet bashkëbisedimit me pjesëmarrësit me pyetje-përgjigje bazuar në një listë pyetjesh orientuese të ndara në 3 kategori: pyetje për familjarët, për bizneset dhe për pushtetin vendor.

Në takim morën pjesë 15 persona që ishin përfaqësues nga Bashkia (Drejtoresha e turizmit dhe specialistë të tjerë), nga biznese vendore, organizata jo fitimprurëse dhe familjarë. Bazuar në pyetjet orientuese, por edhe në përvojën e secilit nga pjesëmarrësit me turistët, gjatë diskutimeve u vunë në dukje njohuritë që ata kishin lidhur me projektin PZHIUT që po zhvillohet duke paraqitur anët pozitive të projektit por edhe problematika dhe rekomandime për zgjidhje/ përmirësime të mundshme. Të ftuarve ju është dërguar paraprakisht me email seti i materialeve si: Agjenda e takimit, Të dhëna mbi projektin dhe Pyetjet e Orientuese të diskutimit. Në fund të këtij dokumenti gjendet listë prezencë e të ftuarve dhe foto të ekranit nga Zoom ([Aneks 4](#)).

### Identifikimi i Çështjeve Kryesore

#### Gjetje kryesore

- Në kuadër të zhvillimit të projektit, ka pasur ndërhyrje në ndriçimin e hyrjes së qytetit dhe vazhdimi i pedonale nga qendra drejt Gurit të qytetit, kjo është realizuar brenda dy viteve të fundit dhe nuk ka ndërhyrje të dukshme nga viti 2019 në 2020.
- Gjatë këtij viti kemi një ulje të numrit të turistëve në vend për shkak të situatës të shkaktuar nga pandemia.
- Turistët vendas ishin më të shumtë në numër krahasuar me ndërkombëtarët.
- Lloji i turistëve (vendas) i kapi të papërgatitur ofruesit e shërbimeve në Përmet për shkak se ishin mësuar me kërkesat e turistëve ndërkombëtarë.
- Mbetjet dhe pastrimi mbetet një problematikë për këtë vend.

- Infrastruktura rrugore që lidh qytetin me fshatrat turistike është një çështje që kërkon zgjedhje të menjëhershme.
- Pavarësisht situatës të shkaktuar nga pandemia, për vitin e ardhshëm qyteti i Përmetit 70%-80% rezervime që tani për vitin e ardhshëm.
- Promovimi është një pikë e rëndësishme në përmirësimin e turizmit në qytetin e Përmetit.

## Familjet

Familjarët e pranishëm në takim theksuan së investimet emergjente në qytetin e Përmetit janë pastrimi dhe mirëmbajtja e vendit. Infrastruktura rrugore për në fshatin Leuzë dhe në Bënjë duhet të marrë një vëmendje të veçantë nga projekti. Gjithashtu duhet një zgjedhje në lidhje me parkimin brenda në qytet.

- Përmirësimi i pastrimit dhe mirëmbajtjes së qytetit dhe fshatrave turistike.
- Infrastruktura rrugore që lidh qytetin me fshatrat si Leuzë dhe Bënjë.
- Një zonë e caktuar për parkimin e makinave si për vendasit dhe turistëve.

## Bizneset/ OJF

Ashtu si vitin e kaluar, përfaqësuesit e bizneseve theksojnë se vitet e fundit ka pasur një rritje shumë të madhe të turistëve që vizitojnë Përmetin dhe kjo për shkak të investimeve private nga sipërmarrës vendas. Edhe përfaqësuesit e bizneseve vlerësuan përmirësimin e infrastrukturës si nevojën më urgjente të bashkisë së Përmetit. U pranua nga bizneset se ky vit ishte shumë ndryshe nga vitet e tjera dhe kërkesat e turistëve vendas ndryshonin me turistët ndërkombëtar.

Promovimi i vendit dhe zonave turistike të bashkisë së Përmetit duhet të jetë nën vëmendjen e pushtetit vendor. Gjatë diskutimeve u përmend se është e nevojshme një bashkëpunim më i fortë midis pushtetit vendor dhe bizneseve për të bërë ndërhyrjet e duhura në mënyrë që të tërheqin sa më shumë turistë. Bashkëpunimi i pushtetit vendor me bizneset do sillte ndërhyrje jo për të mirën individuale por për një zhvillim të përgjithshëm dhe të qëndrueshëm të bashkisë së Përmetit.

- *Promovimi më i gjerë i zonave turistike dhe bizneseve të përfshira në turizëm.*
- *Bashkëpunimi me pushtetin vendor, për ndërhyrje efektive për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit në bashkinë e Përmetit.*

## Pushteti Vendor

Përfaqësues nga pushteti vendor theksuan se gjatë dy viteve të fundit FSHZH ka bërë disa ndërhyrje si, ndriçimi i hyrjes së qytetit dhe vazhdimi i pedonale nga qendra drejt Gurit të qytetit. Përfaqësuesit shprehën se është i nevojshëm krijimi i një regjistri statistikor që gjurmon numrin e turistëve, pasi aktualisht nuk mund të matet fluksi real. Të dhënat për turistët mblidhen nga zyra e informacionit turistik dhe hotelet/bujtina, pra nuk ka një numër real të vizitorëve në këtë qytet.

- *Hartimi i një regjistri për të matur numrin real të turistëve që vizitojnë Përmetin.*
- *Mirëmbajtja dhe Parkimi do të jenë një nga pikat ku do të bazohen ndërhyrjet e ardhshme.*
- *Bashkëpunimi me bizneset dhe promovimi i zonave turistike do të jetë në vëmendjen e vazhdueshme të punonjësve të pushtetit vendor.*

### 3/3 Diskutime në Grup të Fokusuar - Gjirokastrë Hyrje

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QSHKE) si pjesë e zhvillimit të studimit për vlerësimin e zbatimit të Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmit zhvilloi diskutimin në grup të fokusuar në Gjirokastrë, zonë ku janë duke u bërë disa ndërhyrje nga ky projekt. Ky takim u organizua me qëllim ndarjen e gjetjeve paraprake nga studimi sasior i kryer nga QSHKE në muajin Gusht të këtij viti, ndërthurjen e këtyre gjetjeve me disa të dhëna cilësore, si dhe marrjen e të dhënave më të thelluara nga aktorë të përfshirë në zbatimin e projektit në këtë qytet, kryesisht në përputhje me 3 komponentët e projektit: Projektimin urban dhe përmirësimin e infrastrukturës, përmirësimin e zonave turistike, si dhe tregun e turizmit dhe zhvillimi e produkteve.

#### Metodologjia

Në datën 30/09/2020 u zhvillua diskutimi në grup të fokusuar në platformën online “Zoom Meeting” me pjesëmarrës nga Qyteti i Gjirokastrës. Diskutimi nisi në orën 12:00 dhe përfundoi në orën 13:30. Zhvillimi i takimit u drejtua nga M.Sc Bylyre Serjanaj dhe asistuar nga M.Sc Amena Losha duke nisur me prezantim të shkurtër të gjetjeve paraprake të vrojtimit në përgjithësi dhe posaçërisht për qytetin e Gjirokastrës. Më pas takimi vijoi nëpërmjet bashkëbisedimit me pjesëmarrësit me pyetje-përgjigje bazuar në një listë pyetjesh orientuese të ndara në 3 kategori: pyetje për familjarët, për bizneset dhe për pushtetin vendor.

Në takim morën pjesë 14 persona që ishin përfaqësues nga Bashkia (specialistë të turizmit), nga biznese vendore, organizata jo fitimprurëse dhe familjarë. Bazuar në pyetjet orientuese, por edhe në përvojën e secilit nga pjesëmarrësit me turistët, gjatë diskutimeve u vunë në dukje njohuritë që ata kishin lidhur me projektin PZHIUT që po zhvillohet duke paraqitur anët pozitive të projektit por edhe problematika dhe rekomandime për zgjidhje/ përmirësime të mundshme. Të ftuarve ju është dërguar paraprakisht me email seti i materialeve si: Agjenda e takimit, Të dhëna mbi projektin dhe Pyetjet e Orientuese të diskutimit. Në fund të këtij dokumenti gjendet lista e prezencës dhe foto të ekranit nga Zoom ([Aneks 4](#)).

#### Identifikimi i Çështjeve Kryesore

##### Gjetje kryesorë

- Fluks shumë i ulët turistësh në qytetin e Gjirokastrës, pra në bazë të të dhënave nga grupet e fokusuara nuk ekziston një numër realë turistësh këtë vit që ta përdorim si bazë krahasimore me vitin e kaluar.
- Bashkia ka ndërmarrë një hulumtim mbi strukturat akomodues në qytetin e Gjirokastrës, i cili vazhdon akoma. Nga gjetjet shqetësuese është se rreth 60% e bizneseve rezultojnë të mbyllura/pa punë për shkak të situatës së pandemisë.
- Vetëm 20% deri 30% e kapacitetit të shtretërve të biznesit janë plotësuar këtë vit
- Problem mbajtja e regjistrave dhe statistikave nga ana e biznesit për numrin e turistëve, netët e fjetjes etj.
- Koha e qëndrimit të turistëve në Korrik-Gusht, 1-2 ditë.
- Në periudhën Janar- Gusht numri më i lartë i regjistruar ishte 1000 turist nga një biznes, ndërsa të tjerët në këtë hark kohor kanë regjistruar nga 100-200 turist.
- Visit Gjirokastra është një portal ku mund të gjendet dixhitalizimi i atraksionëve në Gjirokastrë, të publikuara në dy gjuhë: anglisht dhe shqip. Një statistikë mbi shikueshmërinë e ëeb-it tregon se gjatë

këtij viti përdorues të faqes online kanë qenë 25,000 vizitorë: vendas pjesa më e madhe prej tyre, për shkak të situatës së përgjithshme të turizmit në vend dhe në botë, dhe një pjesë e turistëve ndërkombëtar nga Amerika, Greqia, Italia, Anglia dhe të tjerë në masë shumë më të vogël.

- Duhet të bëhet ndërhyrje te unaza e madhe në mënyrë që kalimi të bëhet më i thjeshtë. Domethënë janë penalizuar banorët e lagjes së sipërme të pedonales dhe duhet t'u jepet një zgjidhje.
- Shihet me një sy kritik dhe si shumë e nevojshme bashkëpunimi midis strukturave/aktorëve të ndryshëm. Duhet rritur ndërgjegjësimi dhe jo të veprohet individualisht.
- Ndërhyrjet më të shpejta të nevojshme janë: Itenerare, guida, ture sa më të dukshme; rrugicat, lagjet pas kalasë duhet të jenë me kalldrëm; ndricimi i banesave të shpallura monument I dhe II.

## Familjet

Familjarët vlerësojnë shumë pozitivisht ndërtimin e pedonales dhe mirëmbajtjen e qytetit. Pavarësisht bukurisë që jepet pedonale në qytet, mbetet shqetësues lëvizja e banorëve me makinë në lagjet e sipërme të pedonales. Problematikë e shprehur nga familjarët ishte nevoja për sa më shumë hapësira të gjelbërta, hapësira ku fëmijët mund të argëtohen. Ashtu si vitin e kaluar, cilësia e transportit publik, sipas familjarëve nuk kishte ndryshuar fare dhe linte shumë vend për t'u përmirësuar.

- *Ndërhyrje te unaza e madhe për të lehtësuar lëvizjen me makina.*
- *U rekomandua të krijohen zonat rekreative qetësuese për fëmijët dhe moshën e rritur e vonë, gjithashtu dhe përmirësimi transportit publik.*

## Bizneset/ OJF

Përfaqësuesit nga bizneset, pohuan një situatë jo të kënaqshme për sa i përket turizmit në bashkinë e Gjirokastrës. *“Pjesa e turizmit outdoor ka qenë shumë dobët këtë vit. Jo specifikisht për aktivitetin e horse-riding që unë ofroj por në përgjithësi aktivitetet outdoor nuk janë përzgjedhur nga turistët në vitin 2020.”*- u shpreh përfaqësuesi i zgjedhur nga Horse Riding Albania. Nga bizneset u paraqit fakti se rreth 60% e bizneseve rezultojnë të mbyllura/pa punë për shkak të situatës së pandemisë. Vetëm 20% deri 30% e kapacitetit të shtretërve të biznesit janë plotësuar këtë vit, për sa i përket qytetit të Gjirokastrës.

Visit Gjirokastra ka dhënë një output shumë të rëndësishëm nëpërmjet promovimit të dixhitalizuar të shërbimeve të Gjirokastrës – krijimi i ëbsite-it për rritjen e ndërgjegjësimit. Dixhitalizimi i atraksionëve që mund të gesh në Gjirokastrë, janë të publikuara në dy gjuhë: anglisht dhe shqip.

- Shihet me një sy kritik dhe si shumë e nevojshme bashkëpunimi midis strukturave/aktorëve të ndryshëm. Duhet rritur ndërgjegjësimi dhe jo të veprohet individualisht.
- Ndërhyrjet më të shpejta të nevojshme janë: Itenerare, guida, ture sa më të dukshme; rrugicat, lagjet pas kalasë duhet të jenë me kalldrëm; ndricimi i banesave të shpallura monument I dhe II.

## Pushteti Vendor

Përfaqësuesit e Bashkisë ishin shumë të gatshëm për të informuar pjesëmarrësit e tjerë në lidhje me ndërhyrjet e reja që do bëheshin në kuadër të projektit. Numrin zyrtar të turistëve për vitin 2020, e kanë të filtruar nga numri i biletave në muzetë (nga strukturat në varësi të drejtpërdrejtë të bashkisë prej të cilave bashkia mbledh të ardhura). Ajo çfarë vihet re këtë vit është indeksi i konsiderueshëm i turistëve vendas. Në ndihmë të afrimit të turistëve vendas, bashkia Gjirokastrë ka ndërmarrë nisma intensive mbi promocionin



për qytetin e Gjirokastrës. Në periudhën Janar- Gusht numri më i lartë i regjistruar ishte 1000 turist nga një biznes, ndërsa të tjerët në këtë hark kohor kanë regjistruar nga 100-200 turist.

- U premtua një bashkëpunim më i gjerë me aktorë publik dhe privat mbi turizmin e qëndrueshëm në bashkinë e Gjirokastrës.
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe i promovimit të vendit.

### **3/4 Diskutime në Grup të Fokusuar - Saranda**

#### **Hyrje**

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QSHKE) si pjesë e zhvillimit të studimit për vlerësimin e zbatimit të Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmit zhvilloi diskutimin në grup të fokusuar në Sarandë, zonë ku janë duke u bërë disa ndërhyrje nga ky projekt. Ky takim u organizua me qëllim ndarjen e gjetjeve paraprake nga studimi sasior i kryer nga QSHKE në muajin Gusht të këtij viti, ndërthurjen e këtyre gjetjeve me disa të dhëna cilësore, si dhe marrjen e të dhënave më të thelluara nga aktorë të përfshirë në zbatimin e projektit në këtë qytet, kryesisht në përputhje me 3 komponentët e projektit: Projektimin urban dhe përmirësimin e infrastrukturës, përmirësimin e zonave turistike, si dhe tregun e turizmit dhe zhvillimi e produkteve.

#### **Metodologjia**

Në datën 02/10/2020 u zhvillua diskutimi në grup të fokusuar në platformën online “Zoom Meeting” me pjesëmarrës nga Qyteti i Sarandës. Diskutimi nisi në orën 11:30 dhe përfundoi në orën 13:15. Zhvillimi i takimit u drejtua nga M.Sc Bylyre Serjanaj dhe asistuar nga M.Sc Amena Losha duke nisur me prezantim të shkurtër të gjetjeve paraprake të vrojtimit në përgjithësi dhe posaçërisht për qytetin e Sarandës. Më pas takimi vijoi nëpërmjet bashkëbisedimit me pjesëmarrësit me pyetje-përgjigje bazuar në një listë pyetjesh orientuese të ndara në 3 kategori: pyetje për familjarët, për bizneset dhe për pushtetin vendor.

Në takim morën pjesë 14 persona që ishin përfaqësues nga Bashkia (Drejtoresha e turizmit dhe specialistë të tjerë), nga biznese vendore dhe familjarë. Bazuar në pyetjet orientuese, por edhe në përvojën e secilit nga pjesëmarrësit me turistët, gjatë diskutimeve u vunë në dukje njohuritë që ata kishin lidhur me projektin PZHIUT që po zhvillohet duke paraqitur anët pozitive të projektit por edhe problematika dhe rekomandime për zgjidhje/ përmirësime të mundshme. Të ftuarve ju është dërguar paraprakisht me email seti i materialeve si: Agjenda e takimit, Të dhëna mbi projektin dhe Pyetjet e Orientuese të diskutimit. Në fund të këtij dokumenti gjendet listë prezenca e të ftuarve dhe foto të ekranit nga Zoom ([Aneks 4](#)).

#### **Identifikimi i Çështjeve Kryesore**

##### **Gjetje kryesore**

- Turistët vendas shpëtuan turizmin në qytetin e Sarandës. Për shkak të situatës nga pandemia pritej një gjendje më e keqe e turizmit në bashkinë e Sarandës.
- Zbatimi i projektit nuk ka krijuar ndonjë ndryshim të dukshëm nga viti i kaluar në lidhje me bashkinë e Sarandës. Edhe ato ndërhyrje që janë realizuar deri më tani kanë nevojë për përmirësim (shëtitörja).
- Parku i Butrintit i mungojnë shtigjet, në zonën e Syrit të Kaltër mbetet një problem hedhja e mbeturinave, ndërkohë në qytetin e Sarandës mungojnë zonat rekreative për fëmijët dhe për moshën e rritur e vonë.



- Probleme të dukshme me parkimin.
- Terminali i autobusit duhet të marrë një vëmendje më të madhe nga pushteti vendor.
- Mungesa e aktiviteteve për shkak të pandemisë.
- Rekomandohet rritje e cilësisë së gastronomisë vendase dhe mos abuzimi me çmimet.
- Krijimi i “Organizimit të menaxhimit të destinacionit” në mënyrë që rritet promovimi i zonave turistike në Sarandë.

## Familjet

Familjarët e përfshirë në diskutimet online në lidhje me bashkinë e Sarandës shprehën si problematikë mungesën e zonave rekreative, pastrimin e qytetit dhe parkimin në vend. Zonat rekreative janë një problemë që vazhdon ndër vite. Familjarët e kanë të vështirë të gjejnë zona ku mund të çojnë fëmijët e tyre të pushojnë dhe të luajnë.

- *Rekomandohet të krijohet zona të gjelbërta për pushuesit dhe parqe për fëmijët.*
- *Mbarëvajtja e vendit dhe parkimi kanë nevojë për ndërhyrje nga pushteti vendor.*

## Bizneset/ OJF

Përfaqësues nga bizneset pohuan se ky vit ishte shumë i vështirë në lidhje me turizmin. Mungesa e aktiviteteve dhe pandemia patën efekte të mëdha në uljen e numrit të turistëve. Gjithashtu vlen të theksohet se turistët vendas kanë bërë të mundur që disa prej bizneseve të arrinin t'i mbijetonin këtij viti. Bizneset do i ndihmonte shumë një promovim më i madh nga pushteti vendor dhe krijimi i “Organizimit të Menaxhimit të Destinacioneve”.

- *Rekomandohet bashkëpunim më i fortë midis bizneset dhe pushtetit vendor.*
- *Promovimi i vendit dhe krijimi i “Organizimit të Menaxhimit të Destinacioneve”.*

## Pushteti Vendor

Përfaqësuesit e pushteti vendor pohojnë se në krahasim me vitin e kaluar numri i turistëve është vërtetë i ulët (nga 6.8 milion në vitin 2019 në 1 milionë në vitin 2020). “Ky vit nuk është vit i shifrave në lidhje me numrin e turistëve por vit i shpëtimit të industrisë së turizmit”- u shpreh specialisti i turizmit. Turistët ishin larg aktivitetet këtë vit. Gjithashtu, në kuadër të PZHIUT mbeten ende objektiva për t'u realizuar dhe për t'u përmbushënë bashkinë e Sarandës.

- *Bashkëpunimi me bizneset për promovimin e vendit.*
- *Përmbushja e objektivave në kuadër të projektit PZHIUT.*

## Aneks 4: Listë Prezenca dhe Foto DGF

### FOKUS GRUP – PËRMET

Nr.	Emer/ Mbiemër	Institucioni	Kontakti
1.	Gentian Krecig	Biznes	<a href="mailto:krecig@yahoo.com">krecig@yahoo.com</a>
2.	Robert Tabaku	Guidë	<a href="mailto:albturist.permet@gmail.com">albturist.permet@gmail.com</a>
3.	Ardian Gogo	Cesvi	<a href="mailto:gogo.ardian@gmail.com">gogo.ardian@gmail.com</a>
4.	Juli Elezi	Pro Përmet	<a href="mailto:Juli.elezi78@gmail.com">Juli.elezi78@gmail.com</a>
5.	Elidjon Thanasi	Vjosa Explorer	<a href="mailto:vjosa.eksplorert@gmail.com">vjosa.eksplorert@gmail.com</a>
6.	Niko Mihali	CIOFF - Seksioni Ndërkombëtar Shqiptar	<a href="mailto:niko.mihali3@gmail.com">niko.mihali3@gmail.com</a> ; <a href="http://cioff-albania@cioff.org">cioff-albania@cioff.org</a> ;
7.	Ali Delilaj	Mjedis, Ujëra, Pyje (OJF)	<a href="mailto:alidelilaj53@gmail.com">alidelilaj53@gmail.com</a> ;
8.	Vasillaq Nikolla	Biznes Hotel Alvero	<a href="mailto:vnikolla@yahoo.fr">vnikolla@yahoo.fr</a> ;
9.	Eraldo Sakollari	Bashkia Permet	<a href="mailto:aldosakollari@gmail.com">aldosakollari@gmail.com</a>
10.	Klaudja Ciko	Bashkia Permet	<a href="mailto:klaudjanaqellari92@gmail.com">klaudjanaqellari92@gmail.com</a>
11.	Bleona Nurcellari	Bashkia Permet	<a href="mailto:bleona860@yahoo.com">bleona860@yahoo.com</a>
12.	Kristjana Ibrahimimi	Bashkia Permet	<a href="mailto:kristjana.ibrahimi@gmail.com">kristjana.ibrahimi@gmail.com</a>
13.	Shefki Vrenozi	Biznes	<a href="mailto:vrenozishefki@yahoo.com">vrenozishefki@yahoo.com</a>
14.	Amena Losha	ACER	<a href="mailto:Amenallosha@gmail.com">Amenallosha@gmail.com</a>
15.	Bylyre Serjanaj	ACER	<a href="mailto:Bylyre.serjanaj@yahoo.com">Bylyre.serjanaj@yahoo.com</a>

Recording

Participants (15)

- Amena Losha (ACER) (Mute)
- Blytre Sejranaj (Host)
- Alli Dellaj
- Rizaldo Vrenosi
- Vasilqaj Nikolla
- ACER Conference Room
- Bleona
- Cesri Albania
- Elidjon Thanasi
- Eraldo Sakollari
- Klodja Cico
- Kristjana Ibrahim
- Niko M-HALL
- Pro Permet
- Robert

Recording

00:29:54 9:43 AM

### Informacion mbi shpenzimet e turistëve

	Minimum	Maksimum	Mesatare
2016	0	2000	44.49
2018	10	200	52.87
2019	3	200	47.08
2020	10	200	48.54

Në vitin 2020 një turist ka shpenzuar mesatarisht **48.54 Euro/ditë**, e cila në krahasim me vitin 2019, ka pësuar rritje të lehtë prej **1.46 Euro/ditë** të shpenzimeve mesatare ditore (ishte 47.08 Euro/dite).

Next slide

## FALEMINDERIT

Thank you / Mirënjohje

No Notes.

Slide 14 of 15

## FOKUS GRUP – GJIROKASTËR

Nr.	Emer/ Mbiemer	Institucioni	Kontakti
1.	Enkela Caca	Univ. E. Cabej	<a href="mailto:ebabaramo@yahoo.com">ebabaramo@yahoo.com</a>
2.	Ilirjana Zyberi	Univ. E. Cabej	<a href="mailto:izyberi@yahoo.com">izyberi@yahoo.com</a>
3.	Antoneta Polo	Univ. E. Cabej	<a href="mailto:neta_polo@yahoo.com">neta_polo@yahoo.com</a>
4.	Engjell Serjani	Bashkia Gjirokastrë	<a href="mailto:eserjani@hotmail.com">eserjani@hotmail.com</a>
5.	Eni Kaci	Guide	<a href="mailto:enikaci91@gmail.com/">enikaci91@gmail.com/</a> <a href="mailto:info@experiencegjirokastra.com">info@experiencegjirokastra.com</a>
6.	Ilir Hitaj	Ture me kuaj	<a href="mailto:info@horseridingalbania.com/">info@horseridingalbania.com/</a> <a href="mailto:info@visit-gjirokastra.com">info@visit-gjirokastra.com</a>
7.	Edvin Lamce	Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës (GCDO)	<a href="mailto:elamce@gjirokastra.org">elamce@gjirokastra.org</a>
8.	Loena Bakuli	Drejtoreshë e Drejtorisë së Koordinimit Evropian dhe Turizmit	<a href="mailto:bakuliloena@gmail.com">bakuliloena@gmail.com</a>
9.	Alma Gerxhani	Anëtare Bordi DMO Albania	<a href="mailto:info@visit-gjirokastra.com">info@visit-gjirokastra.com</a>
10.	Hevjola Sherifi	Visit Gjirokastra	<a href="mailto:info@visit-gjirokastra.com">info@visit-gjirokastra.com</a>
11.	Rafaela Cika	Univ. E. Cabej	<a href="mailto:cikarafaela1@gmail.com">cikarafaela1@gmail.com</a>
12.	Kliton Nurka	Guidë	<a href="mailto:nurka.kliton@gmail.com">nurka.kliton@gmail.com</a>
13.	Amena Losha	ACER	<a href="mailto:Amenallosha@gmail.com">Amenallosha@gmail.com</a>
14.	Bylyre Serjanaj	ACER	<a href="mailto:Bylyre.serjanaj@yahoo.com">Bylyre.serjanaj@yahoo.com</a>

ACER  
Albanian Center for Economic Research

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT  
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

# PROJEKTI PER ZHVILLIM TE INTEGRUAR URBAN DHE TURIZEM

## 2020- Vrojtimi i Turistëve

Tetor, 2020

Galaxy S8+  
Alma  
Hevjola Sherifi

Remaining Meeting Time: 05:58

Participants (12)



Edvin Lamce  
Katerina  
Galaxy S8+  
Hevjola Sherifi  
Alma

ACER (Me)  
Bijlirë Serjaniq (Host)  
Edvin Lamce  
Er Hëq  
Eni Kap  
Hevjola Sherifi  
Alma  
Enkela's iPhone  
Galaxy S7 edge  
Galaxy S8+  
Katerina  
Loeha Baku/Bashkia Q.robaster

12  
Chat  
Share Screen  
Record  
Reactions

## FOKUS GRUP – BERAT

Nr.	Emër/ Mbiemër	Institucioni	Email
1.	Vladimir Cela	CESVI	<a href="mailto:celavladimir@gmail.com">celavladimir@gmail.com</a>
2.	Marenglen Themeli	BID Berati	<a href="mailto:marenglen.themeli@hotmail.com">marenglen.themeli@hotmail.com</a>
3.	Miklor Pasku	Guide	<a href="mailto:mikli73@gmail.com">mikli73@gmail.com</a>
6.	Etleva Dhima	Bashkia Berat	<a href="mailto:etleva.dhima@bashkiaberat.gov.al">etleva.dhima@bashkiaberat.gov.al</a>
7.	Silvia Merdani	Bashkia Berat	<a href="mailto:silvi.merdani@yahoo.com">silvi.merdani@yahoo.com</a>
8.	Klejda Kusta	Bashkia Berat	<a href="mailto:klejda.kusta@hotmail.com">klejda.kusta@hotmail.com</a>
9.	Ilda Cibaku	Bashkia Berat	<a href="mailto:ilda.cibaku@outlook.com">ilda.cibaku@outlook.com</a>
10.	Marjus Cepelja	Bashkia Berat	<a href="mailto:cepelemarjus2@gmail.com">cepelemarjus2@gmail.com</a>
11.	Luena Golemi	Bashkia Berat	<a href="mailto:golemiluena@yahoo.com">golemiluena@yahoo.com</a>
12.	Arta Dymishi	Shoqata e Mbrojtjes së Dretave të Gruas	<a href="mailto:artadymishi@hotmail.com">artadymishi@hotmail.com</a>
13.	Silvio Greku	Bashkia Berat	<a href="mailto:grekusilvio@gmail.com">grekusilvio@gmail.com</a>
14.	Florjan Kryethi	Drejtor i mbrojtjes së territorit	<a href="mailto:florjankryethi@gmail.com">florjankryethi@gmail.com</a>
15.	Stefo Mato	House of Tourist	<a href="mailto:Houseoftourists@hotmail.com">Houseoftourists@hotmail.com</a>
16.	Amena Losha	ACER	<a href="mailto:Amenallosha@gmail.com">Amenallosha@gmail.com</a>
17.	Bylyre Serjanaj	ACER	<a href="mailto:Bylyre.serjanaj@yahoo.com">Bylyre.serjanaj@yahoo.com</a>



## FOKUS GRUP – SARANDA

Nr.	Emër/ Mbiemër	Institucioni	Email
1.	Aristotel Bita	Bashkia Sarande	<a href="mailto:bashkiasarande@yahoo.com">bashkiasarande@yahoo.com</a>
2.	Lindita Qendro	Bashkia Sarande	<a href="mailto:Lindita.qendro@bashkiasarande.gov.al">Lindita.qendro@bashkiasarande.gov.al</a>
3.	Erjon Biro	Bashkia Sarande	<a href="mailto:Erjon79biro@gmail.com">Erjon79biro@gmail.com</a>
4.	Nertila Behri	Bashkia Sarande	<a href="mailto:nertilabehri@yahoo.com">nertilabehri@yahoo.com</a>
5.	Areti Papadhima	Bashkia Sarande	<a href="mailto:arpina2005@yahoo.com">arpina2005@yahoo.com</a>
6.	Soraldo Nebo	OJF	<a href="mailto:nebosoraldo@gmail.com">nebosoraldo@gmail.com</a>
7.	Alma Harizi	Guide	<a href="mailto:dorinagaci@gmail.com">dorinagaci@gmail.com</a>
8.	Katerina Vela	OJF	<a href="mailto:velakaterina12@gmail.com">velakaterina12@gmail.com</a>
9.	Lorena Mejdani	UT/FE/ Filiali Sarand	<a href="mailto:mejdani.lorena@yahoo.com">mejdani.lorena@yahoo.com</a>
10.	Jonida Muka	Biznes	<a href="mailto:jonidamuka54@gmail.com">jonidamuka54@gmail.com</a>
11.	Serielda Mejdani	UT/FE/ Filiali Sarand	<a href="mailto:serieldamejdani@yahoo.com">serieldamejdani@yahoo.com</a>
12.	Andromahi Qurku	Biznes	<a href="mailto:qandromahi@gmail.com">qandromahi@gmail.com</a>
13.	Amena Losha	ACER	<a href="mailto:Amenallosha@gmail.com">Amenallosha@gmail.com</a>
14.	Bylyre Serjanaj	ACER	<a href="mailto:Bylyre.serjanaj@yahoo.com">Bylyre.serjanaj@yahoo.com</a>



